



INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
INSTITUTI PER HULUMTIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM
INSTITUTE OF SCIENTIFIC RESEARCH AND DEVELOPMENT
ULCINJ - ULQIN



Multidisciplinary Journal of Research
Multidisciplinarni Istraživački Časopis
Revista Kërkimore Multidisciplinare

ISSN 2661-2674 (Online)

ISSN 2661-2658 (Print)



Multidisciplinary Journal of Research „Olcinium,,
Multidisciplinarni Istraživački Časopis „Olcinium,,
Revista kërkimore Multidisciplinare „Olcinium,,

No/Br/Nr. 3
Year/Godina/Viti - 2019



Newsroom

Prof.Ass. Dr. Jetmire Zeqiri, (chief of the editorial)

Prof.Dr.Darko Lacmanović

Dr.Ylvije Kraja

MA..Fidan Kozhani

MA.Sc.Alma Toplana

Editor of the Scientific Magazine

Ma.Artan Osmanoviq

Printing Presses:

Euro Project –Montenegro

Publishing house:

Institute for Scientific Research and Development-Montenegro

- Prof. Dr. Adem Bekteshi (Albania)
- Acad. Slobodan Nešković, (Serbia)
- Acad. Konstantin Pochivalov, (Russia)
- Acad.Dragoljub Mirjanić, (Serbian Rep)
- Prof. Dr. Slađana Benković FON (Serbia)
- Prof. Dr. Robert Dimitrovski (Macedonia)
- Prof. Dr. Akhter Alam(India)
- Prof. Dr. Dragoljub Jankovic (Montenegro)
- Prof. Dr. Tonin Gjuraj(Albania)
- Prof. Dr. Anatoly Avdenko (Ukraine)
- Prof. Dr. Valentin Nedeff (Romania)
- Prof. Dr. Vladimir P. Sergienko (Belorus)
- Prof. Dr. Predrag Dašić (USA)
- Prof. Dr. Laszlo Karpati (Hungary)
- Prof. Dr. Diana Shehu (Albania)
- Prof. Dr. Michael Minch (USA)
- Prof. Asoc. Dr. Blerta Dragusha (Albania)
- Prof. Dr. Niké Wentholt (Netherland)
- Prof. Dr. Drita Kruja (Albania)
- Prof. Dr. Miodrag Brzaković (Serbia)
- Prof. Dr. Andrej Raspor (Slovenia)
- Prof. Dr. Zoran Mastilo (B&H)
- Prof. Dr. Seadin Xhaferi (Macedonia)
- Prof. Asoc. Dr.Azeta Tartaraj (Albania)
- Prof. Dr. Mirsad Nuković (-Serbi)
- Prof. Dr. Tibor Petres (Hungary)
- Prof. Dr. El Thallasinos (Greece)
- Prof.Asc.Dr.Husnija Bibuljica(Kosovo)
- Prof. Dr. Marko Todorović (Serbia)
- Prof. Dr. Heinrich Meister (Switzerland)
- Prof. Ass. Dr. Kamber Kamberi (Kosovo)
- Prof. Dr. Keles Gulbahar (Turkey)
- Prof. Dr. Gëzim Dibra (Albania)
- Mr. Sampurna Mehta (India)
- Prof.Ass.Dr.Behxhet Gaxhiqi(Kosovo)
- Prof. Dr. Rade Ratkovic (Montenegro)
- Prof. Dr.Tonin Gjuraj (Albania)
- Prof. Dr. Alba Robert Dumi (Albania)
- Prof. Dr. Rosemary Ekechukwu (Nigeria)
- Prof.Asc.Dr.Vehbi Ramaj (Kosovo)
- Prof. Dr. Fatos Ukaj (Kosovo)
- Prof. Dr. Radovan Stojanović (Montenegro)

PUNA DHE RENDESIA E SAJ PER MOTIVIMIN E INDIVIDEVE DHE PERFORMANCEN ORGANIZATIVE.....5	
Msc NAJADA MURATAJ, Prof. Dr. ALBA DUMI	
TREGU I PUNES DHE ROLI I GRUAS SIPERMARRESE NE AKTIVITETET TREGETARE DHE EKONOMIKE...19	
MSc ARMANDA QARRI (THANO)	
FAKTORËT QË NDIKOJNË MENAXHIMIN E SUKSESSHËM TË BIZNESIT.....35	
PROF.DR.DIANA SHEHU	
TEHNOLOGIJA INTERMODALNOG TRANSPORTA I USPOSTAVLJANJE SAVJETODAVNOG ISTRAŽIVANJ.....46	
EMIRA DESTANOVIĆ, MR.SC. SAOBRAĆAJA	
ASPEKTE TE ANALIZES SE ROLIT TE DREJTUESVE NE SHKOLLE, KREATIVITETI DHE RENDESIA NE MANAXHIMIN REFORMUES.....54	
ENKELEDA ALI QIBINI, SHEJNAZE GAGICA	
THE ROLE OF ALBANIAN LANGAUAGE TEACHING, AND THE IMPORTANCE OF THIS EDUCATIONAL PROCESS IN CLASS.....69	
FATJONA FILE TOSKA	
THE ADVANTAGE OF THE NEW CURRICULUM IN THE TEACHING PROCESS AND THE SITUATION OF THE SCIENCE MATERIAL PUPILS.....81	
EGLANTINA KUJTIM GOGA	
PSYCHOLOGY OF PRESCHOOL CHILDREN, IMPORTANCE AND METHODS OF TEACHER WORK, THE NEW TEACHING STANDARTS IN DATA BASE INDICATORS.....89	
SUELA AGIM KARATI	
ETHICS IN EDUCATIONAL RESEARCH ONE CRITICAL ELEMENT IN TEACHING ROLE AND TEACHER'S PERSONAL AND PROFESSIONAL LIFE.....101	
Dr MIGENA BALLA, DENADA REXHO, Msc. AVIOLA HAJDINI,	
ELEMINIMI I TATIMEVE TË DYFISHTA NË KOSOVË.....116	
MSC. ARIF KRASNIQI	
NDIKIMI I KONTABILITETIT KREATIV NË RAPORTIMIN FINANCIAR.....130	
Rrustem Asllanaj	
NJË KËNDVËSHTIM ANALITIK- SEMIOTIK I “PËRRALLAVE KOMBËTARE” AT DONAT KURTI.....139	
Lumturi Bardhi	
PASURITË MINERARE SI FAKTOR STRATEGJIK DHE PËRCAKTUES KRYESOR PËR PËRSPEKTIVEN E ZHVILLIMIT EKONOMIK146	
Refik Kryeziu	

PUNA DHE RENDESIA E SAJ PER MOTIVIMIN E INDIVIDEVE DHE PERFORMANCEN ORGANIZATIVE

Vezhgim dhe analize e burimeve dhe literatures bashkohore

Msc NAJADA MURATAJ Prof. Dr. ALBA DUMI

¹Departamenti i Finances, Fakulteti i Shekncave Ekonomike

²Universiteti “Ismail Qemali” Vlore,

Fakulteti Ekonomise

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi është të studiojë perceptimin e punonjësve mbi detyrat e punës fleksibile me theks të vecantë në punën me kohë të pjesshme, nën këndvështrimin e konteksteve të ndryshme në të cilën gjejnë vetveten. Më tej kërkohet të kuptohet efekti i punës me kohë të pjesshme në mënyrën e të punuarit të secilit punonjës. Sipas Nethels nëse dihen kushtet e punës dhe kënaqësia në punën e mësuesve dhe ndikimi kushteve të punës të lidhura me rezultatet e studentëve është e rëndësishme që drejtuesit të përqëndrohen në krijimin dhe mbajtjen e sistemeve të mbështetjes në të gjitha fushat, prandaj të kuptuarit e rolit të drejtuesit në përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve është thelbësor në cilësinë dhe efektivitetin e punës së tyre Nethels (2010). Soltan (2013).

Rishikimi i literaturës diskuton faktorë të ndryshëm që ndikojnë në perceptimin e punonjësve, sikurse janë konteksti publik dhe organizacional si dhe menaxhimi dhe mbështetja e kolegëve. Krijimi i miqësive në ambientin e punës shihet si një faktor i domosdoshëm që sjell përfitime të ndryshme për individë, ekipe/grupe organizata (Asgharian, Yosoff, Mazhari, Merdani, Hazrat dhe Soltan (2013).

Në të njëjtën linjë qëndron dhe studimi i zhvilluar me 500 pedagogë të një universiteti në Pakistan nga të dhënat e të cilit rezultoi se në institucionet edukative marrëdhëniet miqësore bashkëpunuese ndikojnë në mesin e të punësuarve duke rritur nivelin e efikasitetit dhe performancën e punës te punonjësit. Më tej studimi shtrihet në të ardhurat si dhe balancën punë - jetë duke diskutuar më tej edhe teoritë ekzistuese mbi përpjekjet për të ndryshuar punë si dhe ngarkesa e punës në lidhje me detyrat fleksibile. Në fund mbyllet me një diskutim të rolit të faktorëve individual si personaliteti, motivimi, gjinia si dhe situatat e kaluara në jetë.

Organizimi i studimit: Studimi u zhvillua përmes 10 intervistave cilësore të kryera gjatë periudhës korrik -shtator 2018. Qëllimi ishte marrja e një tabloje sa më të plotë të efekteve dhe perceptimeve të detyrave të punës fleksibile përmes intervistimeve të profesionistëve të fushave të ndryshme por dhe të nacionaliteteve të ndryshme. *Soltan (2013).*

Studimi fillon me një pasqyrë të konsoliduar të fushës përkatëse. Ajo studion pjesë të ndryshme të kontekstit në të cilat marrëveshjet fleksibile janë perceptuar dhe vendosur, nga konteksti publik në kontekstin organizativ, duke diskutuar në veçanti elementët e kulturës dhe mbështetjen në vendin e punës përmes menaxhimit dhe kolegëve.

Një model konceptual i fleksibilitetit në vendin e punës është prezantuar nga Hill et al. (2008) dhe është përdorur si një referencë për të prezantuar gjetjet e këtij studimi. *Carlson dhe Grzywacz (2008)* Më pas ajo vazhdon të shqyrtojë rezultatet e fleksibilitetit, fillimisht balancën punë-jetë dhe lidhjen me të ardhurat personale dhe më pas teoritë e lidhura me rezultatet e punës. Së fundi diskutohen faktorët individual si personaliteti, motivimi, situatat jetësore dhe gjinia, të cilat ndikojnë në perceptimin e fleksibilitetit.

Metodologjia e punimit: Në pjesën e metodës së përdorur në studim shqyrtohet procesi i hulumtimit, metoda e kërkimit, përzgjedhja e pjesëmarrësve, intervista dhe analiza e të dhënave, duke theksuar gjithashtu kufizimet dhe kriteret cilësore. Gjetjet e studimit prezantohen në një model që ilustron rëndësinë e faktorëve kontekstual në perceptimin e marrëveshjeve fleksibile të punës dhe rezultatet rrjedhëse *Soltan (2013).* Modeli thekson gjithashtu ndikimin e faktorëve individual në të gjithë elementët e modelit. çdo element i modelit është diskutuar gjerësisht. Studimi mbyllet me një diskutim, duke krahasuar dhe vënë përballë gjetjet me teorinë.

Përfundimet sugjerojnë që mbështetja dhe besimi luajnë një rol dallues në vendosmërinë dhe mënyrën se si i perceptojnë punonjësit detyrat e tyre fleksibile por edhe në rezultatet që vijnë si pasojë e tyre. Gjetje të studimeve të autorëve shqiptarë *Carlson dhe Grzywacz (2008)*

Nga kërkimet për punime të publikuara në Shqipëri në fushën e burimeve njerëzore dhe sjelljes organizacionale për motivimin, kënaqësinë, angazhimin në punë të punonjësve, konkludoj se kjo literaturë është e kufizuar *Soltan (2013)*. Qëllimi i trajtimit të kësaj çështjeje është të njohim gjetjet e autorëve shqiptarë në lidhje me variablat e përfshirë në këtë studim. Kam renditur më poshtë gjetjet e katër studimeve.

Konkretisht studimet përfshijnë faktorët që kanë ndikuar kënaqësinë në punë të mësuesve, faktorët që ndikojnë nivelin e përgjithshëm të motivimit të punonjësve akademikë në Shqipëri, faktorët që demotivojnë punonjësit e sektorit bankar në Shqipëri si dhe faktorët që ndikojnë angazhimin e punonjësve në kontekstin e komunikimit dhe kulturës organizacionale. Për më tepër, ato ndikojnë që efienca e perceptuar të rritet dhe në disa raste mbingarkesa duket të jetë një "efekt anësor" i detyrave të punës fleksibile. *Soltan (2013)*. Gjithsesi, ato ndikojnë që kjo rritje e efiençës të mos i kushtohet vetëm detyrave të punës por dhe faktorëve të ndryshëm që kanë një ndikim si konteksti i lartëpërmendur i diferencave individuale në personalitet, motivim, gjini dhe situatat e kaluara në jetë. *Carlson dhe Grzywacz (2008)*

Fjale kyce: Performanca manaxheriale, roli organizativ, koha e punes, aktivitetet ditore, diferencat individuale, sistemi pages, menduarit ne pune.

1.1. SISTEMET E TË MENDUARIT


Orientimi drejt suksesit dhe performanca në punë

Orientimi drejt suksesit është një tjetër faktor motivues që ndikon në efikasitetin e punës së punonjësve. Të orientosh drejt suksesit nënkupton kënaqësinë që ndjen në këtë vend pune dhe

dëshirën gjithmonë për të qenë produktiv në punë Orientimi drejt suksesit nga ana e punonjësve në një institucion është shumë e rëndësishme. *Burimi: Kotherja O, Univerisiteti i Tiranes*

Kjo për vetë faktin se motivimi për punën do të jetë gjithmonë në rritje ku punonjësi do të punojë për të arritur sukses në punën e tij, e cila do të jetë e dukshme në performancën e punës së tij. *Carlson dhe Grzywacz (2008)*


Studiuesi Ballout në studimin e tij pohon se sukseesi në punë dhe në karrierë te punonjësit ka një rëndësi të madhe për institucionin/organizatën. *Burimi: Universiteti I Tiranes, Polena M, Ceni A.*



Në listën e 10 faktorëve të motivimit të konsideruar universalë dhe të studiuar nga mjaft autorë, faktorët motivues të jashtëm janë: garancia (siguria) për punën, pagat e mira, disiplina në punë dhe kushtet e mira të punës. Garancia (siguria) në punë është një faktor i rëndësishëm sepse ka ndikim në qëndrimin në punë të punonjësve. *Burimi: Universiteti I Tiranes, Polena M, Ceni A.*

Pasiguria përkufizohet si “pafuqia e perceptuar për të mbajtur vazhdimësinë e dëshiruar në një situatë të rrezikuar pune” (*Senge, 1990*). Ajo është e lidhur me emocionet e njeriut. Siguria në punë është shumë e rëndësishme për punonjësën dhe lidhet me angazhimin në punë. Pasiguria në punë redukton përfitimet në punë. *Burimi: Universiteti I Tiranes, Polena M, Ceni A.*


Pasiguria në punë është e dëmshme për rendimentin e organizatës, është kërcënim për burimet e organizatës. (Molins, Soltan (2013) “Punësimi është burim i vlefshëm që njerëzit përpiqen ta mbajnë, mbrojnë, ndërtojnë dhe ajo që aktualisht i rrezikon ata është humbja e këtyre burimeve” (Sora et al., 2009). Pagat e mira janë një nga faktorët më domethënës për motivimin e punonjësve. (Senge, 1990) Carlson dhe Grzywacz (2008)



Organizatat kanë nevojë t’u ofrojnë punonjësve të tyre norma pagash që janë më të larta se në treg. Kjo do të rriste efikasitetin, përgjegjësinë, besimin e punonjësve dhe do të reduktonte shmangiet nga puna. *Burimi: Universiteti I Tiranes, Polena M, Ceni A.*

Norma e pagave që është më e ulët se: Norma në treg në përgjithësi i çon punonjësit drejt pakënaqësisë. Organizatat duhet të maksimizojnë përpjekjet e punonjësve duke rritur normën e pagave më shumë se tregu. (Senge, 1990). Performanca pozitive e fuqisë punëtore dhe pagat e ulëta nuk mund të vazhdojnë të bashkëjetojnë për kohë të gjatë. *Burimi: Universiteti I Tiranes, Polena M, Ceni A.*

Sipas tij mjedisi i punës ndikon shumë në arritjen e qëllimeve duke përfshirë rritjen e kënaqësisë dhe angazhimit të punonjësve, e cila ka një efekt të drejtpërdrejtë në kënaqësinë e karrierës individuale dhe avancimit. *Carlson dhe Grzywacz (2008)*



Që një punonjës të jetë i orientuar drejt suksesit duhet të ketë mbështetje organizative duke bërë që punonjësi të jetë në harmoni dhe me normat e grupit(*Modellin S, 2007* Përshtatja e personit me mjedisin është një forcë dominuese në përzgjedhjen e punonjësve dhe në shpjegimin e kënaqësisë së punës së individëve dhe orientimit drejt suksesit në punë që ndikon edhe në performancën e punonjësve Ballout (2007). *Burimi: Kotherja O, Univerisiteti i Tiranes*


Në mënyrë që të studiohet puna fleksibile dhe dizenjohen politika të tjera punë-jetë për të mbështetur punonjësit me familje apo me angazhime të tjera personale, një kuadër si ai i sistemeve të të menduarit është i nevojshëm.(*Senge, 1990*).Sistemet e të menduarit janë përkufizuar si një disiplinë e të parit të së gjithës, një kuadër për të parë ndërlidhjet dhe jo gjërat si dhe modelet në ndryshim dhe jo ato statike (*Senge, 1990*).

Sipas Herzberg, faktorët të cilët sjellin kënaqësi quhen motivatorë, si, arritje, recognition, rëndësia e vetë punës, përgjegjësi, avancim, rritje, të cilët janë të lidhur me natyrën e vetë punës dhe me

shpërblimet që rezultojnë nga performanca në punë, janë të lidhur drejtpërdrejt me përmbajtjen e punës, si dhe përbëjnë faktorët e brendshëm motivues tek individët. *Modellin S, 2007. Perdorur nga: (Ceni A, Teneqexhi M)*

Faktorët, si rëndësi e punës, përgjegjësia në punë, arritjet në punë shihen si faktorët kryesorë akuzues në qëndrimet relative të sjelljes së punonjësve në punë. *Carlson dhe Grzywacz (2008)*. Situata e qëndrimit të ulët, e cila përfshin faktorët që shfaqin pakënaqësi në punë lidhet me marrëdhënien e individit me mjedisin ose kontekstin e punës, në të cilën ai punon dhe përbëjnë faktorët e jashtëm, si politikat dhe administrimi i kompanisë, kushtet e punës, supervizimi, statusi në punë, siguria në punë, paga, jeta personale, marrëdhëniet interpersonal. *Modellin S, 2007*

Orientimi drejt suksesit dhe performanca në punë Orientimi drejt suksesit është një tjetër faktor motivues që ndikon në efikasitetin e punës së punonjësve. *Carlson dhe Grzywacz (2008)*



Të orientosh drejt suksesit nënkupton kënaqësinë që ndjen në këtë vend pune dhe dëshirën gjithmonë për të qenë produktiv në punë. Orientimi drejt suksesit nga ana e punonjësve në një institucion është shumë e rëndësishme. *Malik (2010)*

Kjo për vetë faktin se motivimi për punën do të jetë gjithmonë në rritje ku punonjësi do të punojë për të arritur sukses në punën e tij, e cila do të jetë e dukshme në performancën e punës së tij.

Studiuesi Ballout në studimin e tij pohon se suksesi në punë dhe në karrierë të punonjësit ka një rëndësi të madhe për institucionin/organizatën. Sipas tij mjedisi i punës ndikon shumë në arritjen e qëllimeve duke përfshirë rritjen e kënaqësisë dhe angazhimit të punonjësve, e cila ka një efekt të drejtpërdrejtë në kënaqësinë e karrierës individuale dhe avancimit. *(Ceni A, Teneqexhi M)*

Këta faktorë që përbëjnë grupin e faktorëve higjienikë arrijnë të parandalojnë pakënaqësinë, por nuk të çojnë në kënaqësi, ato vetëm largojnë ndjenjat negative në punë pra përmirësimi i një faktori të jashtëm nuk do të thotë plotësimi tërësor i nevojave të tyre, por do të ndalojë faktin që ata të jenë të pakënaqur, ndërsa motivuesit janë faktorët e vërtetë që motivojnë dhe kontribuojnë në ndjenjën e kënaqësisë dhe performancës së punonjësit në punë. *Malik (2010)*

Nisur nga këta faktorë është e rëndësishme të dihet niveli i tyre kur duam të vlerësojmë motivimin dhe performancën në punë të punonjësve në çdo kontekst, si dhe liderët menaxherët në lidhje me këtë teori duhet të kuptojnë se, kur ata përmirësojnë një faktor të jashtëm nuk plotësojnë nevojat e tyre që do të thotë nuk çojnë në motivimin e tyre që është bazë në zhvillimi sa më të mirë të performancës në punë. *Carlson dhe Grzywacz (2008)*

Teoria e Herzberg për punën dhe shperblimin ((Ceni A, Teneqexhi M)

Në këtë linjë nëse duam të motivojmë punonjësit në vendin e punës Herzberg (fq.266) sugjeron, theksimin e faktorëve të lidhur me rëndësinë Marrëveshjet e punës fleksibile janë lokalizuar në një sistem social të gjerë që është dinamik dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Sistemet e të menduarit sigurojnë një qasje shumë-shtresore të ekzaminimit dhe njohjes së politikave të punës fleksibile të cilat janë vendosur në shumë shtresa të kontekstit si në praktikën e punës, strukturën dhe kulturën e organizatës. *Carlson dhe Grzywacz (2008)*

Ajo përfshin gjithashtu kontekstin e gjerë social, i cili përfshin faktorët ekonomikë dhe social, modelet e ndërveprimit social, politikat publike, punësimin, kulturën, demografin, gjinin, normat shoqërore dhe vlerat. Mbi të gjitha, sistemet e të menduarit njohin rëndësinë dhe ndikimin e faktorëve kontekstual në eksperiencën e punës së një individi. *Malik (2010)*

Ajo thekson ndërlidhjen e sistemeve të ndryshme dhe faktin se ndryshimet në një sistem do të kenë efekt dhe të tjerët, ashtu si ndryshimet në vendin e punës mund të ndikojnë dhe ndryshojnë jetën private të punonjësve. Ndërkohë, *Carlson dhe Grzywacz (2008)* kanë argumentuar se lidhja midis sistemeve të të menduarit është kritike për të kuptuar lidhjen komplekse midis punës dhe jetës private dhe duhet të jetë tërësisht në gjendje për të analizuar të dyja fushat bashkë. *Malik (2010)*

Roli i kulturës organizative dhe modeli Hofstade

Modeli studimit Hofstede: Kultura luan një rol të madh në sjelljen e të gjithë njerëzve. Ajo përcakton shoqërinë në të cilën ne jetojmë dhe mënyrën e të menduarit apo edhe perceptimin e jetës në përgjithësi. Kultura është konsideruar dhe si një formë e programimit të trurit, i cili ndodh përmes të mësuarit kolektiv, qasjes ndaj ritualeve dhe sjelljes në shoqëri (Hofstede, 1980).


Teoria e Vroom- Yetton

Teoria e Vroom është një ndër teoritë, e cila jep lidhjen midis motivimit dhe performancës në punë ku në bazë të forcës nxitëse individ performon në vendin e punës. Kjo forcë nxitëse varet nga natyra e shpërblimit dhe nga vlerësimi që çdo individ ka në lidhje me këtë shpërblim, i cili bazohet në performancën e punës së punonjësve. Teoria e Vroomit ka datuar që më 1964, e cila dha një shpjegim të detajuar në lidhje me motivimin. *Malik (2010)*

Ajo është e njohur si teoria e përkatësisë dhe argumenton se tendenca për të vepruar në mënyrë të veçantë varet nga forca e pritjes, ku akti do të pasohet nga rezultati dhe nga tërheqja e këtij rezultati nga individ për ta bërë atë më të thjeshtë. Sipas kësaj teorie, Malik thekson (2010) se punonjësit që të jenë të motivuar për të performuar sa më mirë duhet të besojnë se një performancë e mirë e tyre do të çojë në realizimin e qëllimit personal duke u shpërblyer për punën e bërë (fq.145). (*Ceni A, Teneqexhi M*)

Në këtë linjë të shpërblimeve qëndrojnë dhe dy studiues të tjerë Lawler dhe Suttle (1973) të cilët theksojnë se natyra e shpërblimeve ndikon në motivimin e punonjësve dhe kjo shfaqet dukshëm

në performancën e punës (f.500) pra duke ndikuar drejtpërdrejtë në produktivitetin e punës. Teoria e pritshmërisë ka evoluar vitet e fundit si një paradigmë themelore për studimin e qëndrimeve njerëzore, sjelljeve njerëzore në të ardhurat e organizatës. *Malik (2010)*



Kjo teori bazohet në tri elemente që janë: pritshmëria, instrumentaliteti dhe valenca. Një person është i motivuar nëse ai/ajo beson se përpjekja në punë do të çojë në një performancë të përshtatshme bazuar në përpjekjen individuale (pritshmëria), performanca në punë do të shpërblehet (instrumentaliteti), vlera e shpërblimeve do të jetë pozitive (valenca) (*Greenhaus dhe Beutell, 1985*).

Në nivelin organizativ, kultura organizative mund të përkufizohet si "shpërndarje perceptimesh të praktikave organizacionale të punës brenda njësive organizative që mund të ndryshojnë me njësitë organizative të tjera" (Van Den Berg dhe Wilderom, 2004, p.571) Kultura e një organizate përkufizohet kështu në mënyra të caktuara, të cilat kanë evoluar me kohën (*Ceni A, Teneqexhi M*). Një tjetër qasje ndaj konceptit kulturor thekson vlerat; ajo cfarë i karakterizon organizatat më të mira janë vlerat të cilat cdo punonjës përkushtohet shumë (Peters dhe Waterman, 1982). Koncepti i kulturës është shumë i ngjashëm me konceptin e klimës organizative, i cili në mënyrë tipike bazohet mbi perceptimet e punonjësve për praktikat organizative dhe procedurat. (*Bryman dhe Bell, 2007*).

BALANCA PUNË-JETË DHE NDERVEPRIMI PERSONAL

Ndërveprimi midis jetës personale dhe asaj profesionale është një çështje që është studiuar gjerësisht gjatë viteve të fundit. Kërkimi është fokusuar kryesisht në përhapjen apo pasurimin midis dy fushave që sugjerojnë se ndjenjat ose sjelljet në një fushë ndikojnë në ndjenjat apo sjelljet e fushës tjetër. *(Ceni A, Teneqexhi M)*

Premisa themelore është që të dy fushat janë në konflikt. *(Bryman dhe Bell, 2007)*. Kjo bazohet në teorinë e roleve, e cila përcakton se përgjegjësitë nga fusha të ndryshme konkurojnë midis kufizimeve në kohë, energji apo burime mendore të një individi, i cili krijon një rol të sforcuar *(Greenhaus dhe Beutell, 1985)*. Duke ju referuar kësaj teorie pjesmarrja në një rol është më e vështirë për shkak të pjesmarrjes në rolin tjetër. *(Bryman dhe Bell, 2007)*. *Perdorur dhe nga: (Ceni A, Teneqexhi M)*

METODOLOGJIA DHE ANALIZA E KONCEPTVE TEORIKE

Studimi shqyrton marrëveshjet fleksibile të punës me theks të veçantë në punën me kohë të pjesshme dhe është bazuar në pyetjet e mëposhtme kërkimore:

1. A ndikon puna fleksibile në mënyrën me të cilën punoni?
2. Nëse po, si?
3. Cilët elementë luajnë rol në mënyrën se si ju perceptoni marrëveshjet fleksibile të punës?
4. Studimi është ndërtuar si një kërkim cilësor që është në gjendje të japë informacion përmes opinioneve dhe eksperiencave të të intervistuarve.
5. Të intervistuarit janë zgjedhur nga rrethi ngushtë shoqëror dhe me rekomandimet e tyre, duke përmbushur kriterin kryesor të të punuarit të më pak se 40 orëve në javë.

Kërkimet cilësore e vendosin theksin tek fjalët dhe jo tek numrat dhe lejon daljen e teorive nga të dhënat. Ajo thekson të kuptuarin e botës sociale nëpërmjet interpretimit të saj nga ana e

pjesmarrësve dhe lejon që sjelljet sociale të shqyrtohen si rezultat i bashkëveprimit midis individëve sesa si një fenomen i vecantë (*Bryman dhe Bell, 2007*).

TEORIA E MCGREGOR VS ME TEORINË X DHE TEORINË Y

Teoria e McGregor (1960) e cila është ngritur mbi teorinë e Maslow-t shton një ide kryesore, supozimet e menaxherëve rreth punonjësve të tyre mund të ndikojnë motivimin e tyre. Kjo teori propozon dy alternativa dhe pikpamje ekstreme për ta parë një qenie njerëzore: teorinë X dhe teorinë Y. Sipas teorisë X, punonjësi shihet kryesisht si negativ, përtac, i reziston ndryshimit dhe nuk është i aftë të motivohet. Kjo sjell një mjedis të kontrolluar me rregulla strikte, kërcënime dhe ndëshkime. Punonjësit në një organizatë, për të patur performancë më pak efikase, me produktivitet të ulët, e pëlqejnë këtë prirje, duke dhënë agresione dhe konflikte. Teoria Y nga ana tjetër përpjeket të maksimizojë qëllimet individuale dhe përpjekjet e punonjësit duke u dhënë atyre përfshirje dhe autonomi më të madhe në punë. (*Ceni A, Teneqexhi M*)

Kjo do të thotë që punonjësve u jepet mundësia për t'u rritur dhe arritur qëllimet e tyre brenda organizatës. Literatura tregon që ka dy tipe rolesh të sforcuar që lidhen me konfliktin punë-familje: mbingarkesa, kur kërkesa për kohë dhe energji në kryerjen e të dy roleve njëkohësisht është shumë e madhe për tu mbajtur, duke e bërë të vështirë kryerjen e të dy roleve. (*Ceni A, Teneqexhi M*)

Literatura ka siguruar gjithashtu të dhëna për teorinë e zgjerimit të rolit, e cila ka një qëndrim më pozitiv mbi konceptin e balancës punë-familje dhe është tërhequr mbi këtë aspekt nga një rol që siguron burime që lehtësojnë tjetrin, prandaj pjesmarrja në një rol thekson pjesmarrjen në tjetrin dhe anasjelltas.

PERFUNDIMET DHE ANALIZA E BURIMEVE NGA LITERATURA

Individët kanë vlera, etik, të kaluar, karakteristika dhe perceptime të ndryshme ndaj mjedisit të tyre bazuar në diferencat e këtyre faktorëve individualë. Të njëjtët faktorë aplikohen kur shikohet se si punonjësit i përgjigjen punës së tyre, si e shohin mbikqyrësin dhe kolegët dhe si reagojnë ndaj presionit dhe pritshmërive. Veç kësaj, këto faktorë ndikojnë gjithashtu dhe në motivim. Pyetja nuk është se si njerëzit motivohen por "kush" motivohet nga "çfarë". Për të kuptuar më mirë diferencat në faktorët individualë në këtë kontekst është e nevojshme kuptimi i personalitetit. *(Ceni A, Teneqexhi M)*

Modeli i pesë faktorëve të personalitetit është më i zakonshmi dhe struktura e personalitetit e përdorur gjerësisht gjatë kohës tonë është zbuluar fillimisht në vitin 1961 nga Tupes dhe Christal. Ai konsiston në pesë trajtime të ndryshme të personalitetit. *(Ceni A, Teneqexhi M)*

Hapja përballë përvojës paraqet krijimtari, fleksibilitet, kureshtje dhe të qenit i pazakontë ndërsa të qenit i pranueshëm i referohet prirjes për të qenë i butë, i sjellshëm, i besuar dhe i dashur. Së fundi, individët e ndërgjegjshëm janë të orientuar nga arritjet dhe janë të besueshëm, të organizuar dhe me qëllime të qarta (Judge, Ilies, 2002). Carrelli dhe Dittrichu (1978) përshkruajnë se pjesa më e madhe e teoricienëve që diskutojnë teorinë e barazisë përcaktojnë tri pika kryesore. *(Ceni A, Teneqexhi M)*

1. Së pari, punonjësit e perceptojnë një kthim të drejtë për atë çfarë kontribuojnë në punën e tyre.
2. Së dyti, punonjësit më pas drejtojnë një lloj krahasimi social me kolegët e tyre për shpërblimin.
3. Së treti, çdo punonjës që e percepton veten të jetë në një situatë të pabarabartë do të përpiqet të reduktojë këtë pabarazi. Robbins (2003) dhe Adams (1963; 1965,
4. Harder 1991) shpjegojnë se teoria e barazisë është një teori që bazohet në drejtësinë e perceptuar të një individi.
5. Një punonjës reflekton se sa përpjekje duhet të bëjë ai dhe e krahason këtë me atë që ai ka marrë nga kontributi i tij.

6. Pas këtij vlerësimi individual të raportit të vet input - output, ai do të krahasojë raportin e vet input - output me raportet e kolegëve të tij të drejtpërdrejtë.
7. Nëse punonjësi e konsideron raportin e vet input - output se është i barabartë me raportet e punonjësve të tjerë, ekziston një gjendje barazie.
8. Punonjësi do të ndjejë që është trajtuar në mënyrë të drejtë.
9. Në këtë situatë barazie personi është i kënaqur.

REFERENCAT: Trope, Y. (1975). Journal of Personality and Social Psychology, 32(6), 1004-1013

Vroom, V. (1964). Work and Motivation. New York, NY: Wiley. In Isaac, R. G., Zerbe, W. J., & Pitt, D. C. (2001).

Leadership and motivation: The effective application of expectancy theory. Journal of Managerial Issues, 13(2), 212.

Vroom, V.H. (1995). Work and motivation. San Francisco, CA: Jossey-Bass Publishers Wahba, M. A. and House, R. J. (1972). Expectancy theory in managerial motivation.

Academy of Management Proceedings, 69-70. Wanous, J. P., Poland, T. D. Premack, S. L. and Davis, K. S. (1992).

The effects of met expectations on newcomer attitudes and behaviors: A review and meta-analysis. Journal of Applied Psychology, 77(3), 288-297. Waseem Khan and Yawar Iqbal (2013).

An investigation of the relationship between work motivation (intrinsic & extrinsic) and employee engagement: a study on Allied Bank of Pakistan. www.diva-portal.org/smash/get/diva2.../fulltext03

TREGU I PUNES DHE ROLI I GRUAS SIPERMARRESE NE AKTIVITETET TREGETARE DHE EKONOMIKE

MsC ARMANDA QARRI (THANO)

Fakulteti i Ekonomise, Departamenti Manaxhimit

Universiteti “Ismail Qemali”

Vlore, Albania

Abstrakt: Kemi zgjedhur këtë temë pasi është një temë mjaft aktuale ditët e sotme dhe shumë interesante për tu studiuar. Fuqizimi i gruas vitet e fundit është diçka që ndikon si në ndryshimet sociale ashtu edhe në ato ekonomike të një vendi. Gratë janë shndërruar në çelsin e suksesit të cdo kompanie pasi ato përbëjnë numrin më të madhë të konsumatorëve. Fuqia e tyre ka bërë që ato të jenë misteri më i madh për cdo kompani që do të rritet. Përfitimi i sa më shumë konsumatoreve femra do të thotë rritje e shitjeve. Megjithëse fuqizimi i grave është tashmë një fakt i pamohueshëm shumë kompani vazhdojnë ta neglizhojnë atë si një fuqi e madhe blerëse.

Hipoteza: Bizneset duhet ta orientojnë marketingun e tyre nga gratë pasi ato janë konsumatoret më të mëdha.

Si hipotezë kemi shtruar dy variabla që janë marketingu i bizneseve dhe gratë si konsumatoret më të mëdha. Duam të tregojmë lidhjen që këto dy variabla kanë, duke parë fillimisht se si ndikojnë gratë në rritjen e një biznesi dhe më pas duke parë sjelljen e bizneseve kundrejt grave. Objektivi kryesor i zhvillimit të temës është të kuptohet rëndësia që gratë kanë në zhvillimin e biznesve. Fillimisht kemi trajtuar fuqizimin e femrës, sesi ajo është shndërruar nga një individ ku nuk kishte asnjë të drejtë në një individ që po bën revolucion në botë nëpërmjet fuqisë së saj.

FJALET KYCE: Ekonomia kombetare, Roli i gruas sipermarrese, aktivitete ekonomike, SME, planifikim financiar, planifikim i burimeve, strategji konkures, planifikim dhe organizim.

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM:

Kemi trajtuar marrëdhënien midis grave dhe burrave si ka qënë dhe si ka ardhur në ditët e sotme. Ndikimi i arsimimit të grave në fuqizimin e tyre. Pjesëmarrja në arsim sipas gjinisë e më pas pjesëmarrja në tregun e punës si dhe vështirësitë që hasin gratë në për të qënë pjesë e këtij tregu. Kemi vazhduar zhvillimin e temës duke parë gratë si konsumatorët më të mëdha. Duke studiuar tregun e tyre jemi njohur me kërkesat që ato kanë ndaj marketerëve dhe arsyet se pse gratë blejnë. Kemi parë gratë si fuqia blerëse më e madhe dhe kjo gjë kthen ato në një treg mjaft të kërkuar nga marketerët.

Objektiva kryesore ne punim: Në fund kemi shqyrtuar tregun e kozmetikës, i cili është një treg mjaft i rëndësishëm për femrat. Kemi dhënë shembuj të disa kompanive të suksesshme të këtij tregu duke parë se si ato përpiqen ti tërheqin gratë dhe të krijojnë një marrëdhënie afatgjatë me to. Gjithashtu kemi paraqitur se çfarë duhet të kenë parasysh marketerët kur u drejtohen tregut të grave. Duke hequr dorë nga synimi i turmës për të kuptuar dhe për të njohur blerëset e tyre më të mëdha.

Gratë kudo në botë kanë role të shumëfishta si nëna, gra, punonjëse, përgjegjëse të shëndetit dhe menaxhere të shtëpisë. Në dekadën që ne po jetojmë rreth një miliard gra po vazhdojnë të punojnë e të fitojnë (Silverstein & Sayre, What a Women Wont, 2008) ekonomikisht ato po sjellin ndryshime të rëndësishme në treg dhe në të gjithë botën. Shumë prioritetë bien në kundërshtim me njëra-tjetrën pra: Jo vetëm se ka shumë gjëra në listën që duhet të bërë, por shumë nga to bien në konflikt se cila duhet bërë më para e cila më mbrapa.

1.2 Qellimi dhe rendesia e punimit shkencor:

Ndikimi ekonomik dhe politik i grave në sektorin privat dhe publik ka filluar që prej vitit 1940 ku për herë të parë gratë u larguan nga shtëpia për tju përgjigjur mungesës që u krijua nga largimi i shumë burrave në luftë por me kalimin e viteve gjërat filluan të ndryshojnë. Në vitin 2007 regjistrimet e fundit tregojnë se për herë të parë në histori gratë e pamartuara e tejkalojnë numrin e grave të martuara në SHBA.

Këto të dhëna tregojnë qartë për një shpërndarje të grave nga varësia mashkullore dhe për një fuqizim të madh të tyre. Marrë në tërësi, të gjitha këto trende kanë prodhuar ndryshime sizmike si në shtëpi ashtu edhe në forcën e punës. Sot gratë janë ndoshta audienca më e rëndësishme dhe forca më e madhe drejtuese.

Fuqia ekonomike e grave është në rritje. Një studim i kohëve të fundit nga Bordi i Rezerves Federale ka treguar se gratë kontrollojnë pak më shumë se gjysmën e të gjithë pasurisë personale në SHBA (51.3%). Por kjo është vetëm maja e ajzbergut. Ka të dhëna të sigurta se ky grup do të vazhdojë të rritet. Njeri prej treguesve është arsimimi. Sot më shumë gra së kurrë janë duke marrë arsim universitar. Gjatë 30 viteve të fundit të ardhurat e grave janë rritur më shumë se 60% ndërsa të ardhurat mesatare të meshkujve kanë qëndruar pak a shumë të njëjta. Ky fenomen tregon që ska asnjë shenjë rritëse.

Faktori i rritjes ekonomike nuk është e vetmja forcë e rëndësishme që gratë kanë. Shumë përfitime jo-ekonomike vijnë nga mbështetja dhe besnikëria e krijuar. Kur ju tregtoni për gratë, ju përfitoni nga mjeti më i fuqishëm i marketingut në botë :fjala e gojës. Shpërndarja e fjalës me anë të bashkëbisedimit është më e përhapur te femrat se te meshkujt pasi këta të fundit janë më të rezervuar. Gratë kur besojnë në një markë ato ndihmojnë që dhe të tjerët të besojnë duke përhapur fjalën e mirë në miq, familjare të afërm .

Nëpërmjet studimit të bërë ne do të përpiqemi të vërtetojmë rëndësinë e grave dhe pse bizneset duhet ta orientojnë marketingun drejt tyre.

Kjo do bëhet e mundur duke paraqitur faktet e ndryshimit dhe fuqizimit të gruas si dhe nëpërmjet pyetjeve kërkimore të tipit:

- *Pse duhet synuar tregu i grave?*
- *Çfarë i bën gratë një treg i vlefshëm?*
- *Pse blejnë gratë?*
- *Çfarë duhet të kenë parasysh marketerët kur i drejtohen grave?*

1.4 Metodologjia e përdorur në hulumtimin shkencor:

Studimi është zhvilluar mbi bazë të kërkimit sekondar. Duke qënë se punimi ka të bëjë me marrëdhënien e bizneseve me gratë ne jemi bazuar kryesisht mbi literaturën që flet pikërisht për marrëdhënien e marketingut dhe të bizneseve me konsumatorin femër. Ndër to mund të përmendim: “Marketing to Women”-Marti Barletta,”Women Want More”- M.Silverstein Katharine Sayre, “Just ask a Women”-Mary Lou Quinlan.

Si çdo kërkim dhe ky ka pasur probleme të shumta nëmbledhjen e informacionit. Pjesa më e madhe është marrë dhe është përkthyer nga literatura e huaj pasi ishte e pamundur të gjeje njëinformacionzyrtar në gjuhën shqipe. Gjithashtu një tjetër problem i hasur gjatë punës është mungesa e informacioneve të rifreskuara për vitin aktual.

Gratë gjatë gjithë kohës kanë qënë duke luftuar me botën e meshkujve. Për të pasur të drejtat që meshkujt kanë, dhe të jenë të pavarura prej tyre. Kohët kanë ndryshuar, duke i bërë gratë shumë më të fuqishme edhe të afta për të patur të njëjtat të drejta si burrat. Gjatë dy shekujve të fundit gratë kanë treguar ndryshime në situata të reja dhe përmirësimin e roleve të tyre brenda shoqërisë. Për më tepër, roli i tyre është rritur (The role of women in our society has changed) me kalimin e kohës dhe sot ato janë të mbingarkuara me detyra dhe përgjegjësi të ndryshme. Së pari, në shekullin e18-të gratë kishin shumë më pak të drejta nëse i krahasojmë me meshkujt. Gratë në përgjithësi ishin shtëpiake, merreshin me rritjen e fëmijëve dhe lireshin në mëshirën e burrit të tyre për tu mbajtur gjallë.

Një grua kishte vetëm mundësinë për të qënë një shërbëtoe e thjeshtë. Burrat i konsideronin gratë si qytetare të klasës së dytë dhe që nuk kishin asnjë të drejtë. Kjo situatë filloi të ndryshonte në shekullin e19-të sepse gratë u bashkuan për të luftuar me agresivitet për të drejtat e tyre, diçka që gjithmonë është dukur sikur kishte zënë një vend të dytë në shoqëri. Së dyti, u deshën disa dekada që gratët merrnin të drejtën e votës. Para të dyzetave grave nuk ju lejohej të votonin, vetëm meshkujt kishin këtë të drejtë. Kjo zgjati deri në vitin 1947, ku po në këtë vit u regjistrua një amendament i Kushtetutës i cili i jepte të gjitha grave të drejtën e votës. Ato mund të zgjidhnin përfaqësuesin e tyre. Gratë zgjidhnin qeverinë e tyre, politikat e tyre dhe u lejuan të marrin pjesë në demokraci për herë të parë në jetë. Gjithashtu në të njëjtin vit gratë filluan të luftojnë për të drejtat e tyre përsa i përket kushteve të punës. Shumë gra filluan të gjejnë mundësi punësimi në shumë fusha të ndryshme, kryesisht në sektorin e edukimit dhe infermierisë.

2. Analiza e punimit shkencor dhe studimi i literaturës

Shumë prej nesh kanë parasysh ato rolet tradicionale në një familje ku burri shkon punon në zyrë ndërsa gruaja duhet të mbaj shtëpinë. Por kjo situatë tashmë ka ndryshuar. Në 2050 pritet që grate të përbëjnë mbi 47 % të fuqisë punëtore në Shtetet e Bashkuara ,ndryshe nga viti 1950 ku gratë kanë qënë 30 % e fuqisë punëtore megjithëse shumë ekspert thonë se në një kohë afat shkurtër

numri i grave në fuqinë punëtore do e kaloj numrin e burrave. Kjo për arsye se në 2008-ën shumë punë dhe industri të dominuara nga burrat filluan të zhdukeshin si psh. puna e prodhimit.

Duke qënë se kohët kanë ndryshuar, rolet e burrave dhe grave janë më pak të përcaktuara. Mund të themi se këto ndryshime që kanë ndodhur e kanë rritur edhe më shumë rolin e gruas jo vetëm në familje por edhe në shoqëri e ekonomi.

Arsimimi është çelsi për krijimin e barazisë gjinore. Investimi në edukimin e grave do ishte një ndër investimet kryesore për vendet e varfra që duan zhvillimin. Në nivel makroekonomik arsimimi I gruas është I lidhur ngushtë me produktivitetin e lartë, kthim të lartë investimi etj. Ashtu si arsimi mbështet rritjen ekonomike edhe rritja ekonomike mbështet përmirsimet në arsim dhe shëndetësi. Shkollimi fillor dhe I mesëm njihen si çështjet themelore të ndryshimeve sociale dhe makro ekonomike. Më pak vëmendje shkon për shkollimin e lart I cili luan një rol kyç plotësues.

Si përmenda dhe më lart edukimi është një mjet I fuqishëm I reduktimit të pabarazisë midis gjinive. Ai mund ti jap njerëzve aftësinë për të marrë në kontroll jetën e tyre. Gratë të cilat vazhdojnë të diskriminohen në shumë sfera të jetës kanë nevojë të veçantë për këtë mënyrë nxitje. Si ka cituar dhe fituesja e cmimit Nobel ne 2003 : “Një grua e arsimuar nuk do të mposhtet nga presionet e shumta që I shfaqen”.

Megjithëse sot ne jemi ende larg dhënies të së drejtës dhe shanseve të barabarta për edukimin e grave (Gender Statistics Manual, 2013) nëqoftëse I krahasojmë me mundësitë që meshkujt kanë. Në shumë shoqëri, familjet ende hezitojnë të dërgojnë vajzat e tyre në shkollë .Shpesh herë ato janë të parat që largohen nga shkolla në momentin e mos sigurimit të parave për edukimin e fëmijëve. Tekstet e përdorura në shkolla shpesh shërbejnë për të forcuar idenë tradicionale për gratë si nëna, amvisa dhe jo si persona aktive në jetën publike.

Edhe në ato shoqëri që çështja e barazisë në arsim nuk ka pasur shumë probleme, studentet femra ende priren të studiojnë ato degë që të çojnë në karriere me pagë më të ulet dhe me më pak status duke u krahasuar me meshkujt. Në tregun e punës gratë kanë ndërmarrë hapa të mëdha por ende nuk kanë mundur të arrijnë barazinë e plotë. Vajzat kanë tendencë të përparojnë më shumë se meshkujt në shkollë. Në shumicën e vendeve figuron se djemtë e përsërisin arsimin fillor më shumë se vajzat.

Në nivel global shohim se kemi një rritje si të shkallës së arsimimit ashtu edhe të barazisë gjinore këto 20 vitet e fundit. Shkalla e shkrim-leximit është rritur ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme. Insituti i statistikave UNESCO-S ka nxjerrë të dhëna te reja mbi analfabetizmin dhe edukimin e të rinjve në Prill të vitit 2012. Në nivel rajonal normat e shkrim dhe leximit janë më të larta në Azine Qëndrore ,Amerikën Latine, Karaibe,në Europën Qëndrore dhe Lindore,Azin lindore dhe Paqësorin. Niveli I shkollimit supozohet të jetë i lartë në Amerikën e Veriut dhe në Europën Perëndimore por nuk ka të dhëna të sakta në mënyrë që të bëhet e mundur llogaritja e një mesatareje rajonale. Normat më të ulta të arsimimit janë në shtetet Arabe, Azia Jugore dhe Perëndimore. Shkollimi I femrave globalisht është vlerësuar të jetë 80% në vitin 2010 duke u krahasuar me atë të burrave I cili shkonte 89%. Si rezultat gati 2/3 e popullsisë analfabete në vitin 2010 përbëhej nga gratë.

Rajoni	Shkalla e arsimit per te rriturve (%)			Shkalla e arsimit Per te rinjte (%)		
	Total	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra
Shtetet Arabe	74.7	83.3	65.7	89.1	92.4	85.6
Azia Qendrore	99.5	99.6	99.4	99.7	99.6	99.8
Europa Qendrore dhe Lindore	97.9	99.0	97.0	99.1	99.3	98.9
Azia Lindore dhe Paqsori	94.2	96.7	91.6	98.8	98.9	98.7
Amerila latine dhe Karaibet	91.4	92.1	90.7	97.2	97.0	97.4
Amerika e Veriut dhe Europa Perendimore	-	-	-	-	-	-
Azia Jug-Perendimore	62.7	74.0	51.8	80.5	86.6	74.7
Sub-Afrika	62.6	71.0	54.2	71.8	76.4	66.8
Bota	84.1	88.6	79.7	89.6	92.2	87.1

(UNESCO INSTITUTE FOR STATISTICS, 2012)


Prezenca e femrës në korporata të mëdha në botë, që është në rritje gjithnjë, është modeste nëse bëjmë krahasimin me suksesin e femrave si biznesmene dhe sipërmarrëse. Në vitin 2007, 40% e femrave zotëronin një firmë në Amerikë- në të cilat punësojnë 13 milion njerëz dhe gjenerojnë 1.7 trilion dollar me shitje. Bizneset që udhëhiqen nga femrat janë rritur gati dy herë në Amerikë në krahasim me bizneset që udhëhiqen nga meshkujt.

Femrat janë vazhdimisht në rritje në të gjithë botën (Gender and Development), duke kontribuar në të ardhurat familjare dhe rritjen e ekonomive kombëtare. Megjithatë, gratë përballen me shumë probleme si në kohë, kufizime njerëzore, fizike dhe sociale që kufizojnë aftësinë e tyre për bërë të mundur rritjen e bizneset të tyre. Po femrat sipërmarrëse po japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë në mbarë botën. Në SHBA gratë që kanë në pronësi firma po rriten gjithnjë e më shumë duke qenë përgjegjëse për 23 milione vende pune. Gjithashtu shihet një rritje e sipërmarrjes femërore në vendet e zhvilluara.

Femrat nuk synojnë të ardhura më të mëdha apo ndikohen nga ky fakt vetëm sepse dëshirojnë të fitojnë më shumë para. Ato përgjithsisht nuk janë akumulator të pasurisë apo të masin vetveten se sa fitojnë apo çfarë asetesh kanë. Sidoqoftë, paratë janë me rëndësi për femrat, fillimisht si markues të statusit të tyre dhe ndikimin në punët e shtëpisë. Kur femra i rrit të ardhurat financiare, kontribon në financat e shtëpisë dhe i kontrollon vet asetet e veta, ato janë më të fuqishme. Të gjitha femrat punojnë shumë për bilancin e parave në mes të shtëpisë dhe shpenzimeve të tjera dhe sa më shumë të fitojnë aq më të suksesshme janë në këtë detyrë. Paraja krijon edhe fleksibilitet tek femrat duke u mundësuar atyre të blejnë kohë shtesë.

Pavarsisht progreseve të bëra gjatë dekadave të fundit për barazi gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në forcën punëtore, ende ka shumë për të bërë pasi problemi i barazisë vazhdon të ekzistoj dhe në ditët e sotme. Edhe pse shumë gra janë bërë sipërmarrëse të suksesshme ato ende janë të

nënvlerësuar dhe jo shumë të përfaqësuar në bordet drejtuese në botë. Në botë gratë vazhdojnë të formojnë një shumicë të madhe të të punësuarve me të ardhura të ulta dhe që preken shpeshherë nga papunsia afatgjatë. Kjo vjen si pasojë e disavantazheve social-ekonomike të grave të shkaktuara nga diskriminimi me bazë gjinore.



(Employment rates by sex, 2011, 2012)

Sipas analizës së InstituteWomen Policy Researches (Institute for Women's Policy Researches, 2013) në raportin e punësimit të muajit Maj nga Byroja e statistikave të punës në SHBA numri I grave në tregun e punës është rritur ndjeshëm në muajin Prill në krahasim me muajin e mëparshëm.

Në 165.000 vende pune që ishin në total të shtuara nga aktivitetet e borderove, gratë fituan 117.000 vende pune (71%) ndërsa burrat 48.000 vende pune (29 %).

Fuqizimi ekonomik I grave në të gjithë botën e pasur është një nga revolucionet më të rëndësishme të 50 viteve të fundit (Female power, 2009). Kjo është e rëndësishme për shkak të shtrirjes së madhe të ndryshimeve ku miliona gra të cilët dikur ishin të varura nga burrat kanë marrë kontrollin e tyre ekonomik, si dhe të fateve të tyre. Prirja e rritjes së grave në tregun e punës është pothuajse e sigurt për të vazhduar. Në Bashkimin Evropian gratë kanë plotësuar 6 milion prej 8 milion vende pune të reja të krijuara që nga viti 2000. Në Amerikë tre nga katër njerëz të hequr nga puna që nga fillimi i recesionit janë meshkuj. Shkalla e papunësisë tek femrat është 8.6%, kundrejt 11.2% që është papunësia e burrave.

Goldman Sachs llogarit që (Female power, 2009), duke lënë të gjitha gjërat e tjera të barabarta, duke rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës do të rritet GDP me 21% në Itali, 19% në Spanjë, 16% në Japoni, 9% në Amerikë, Franca dhe Gjermania, dhe 8% në Britani.

Nëkëto 3-4 dekada studimi e dallimeve mes grave dhe burrave. Shumë gjera janë mësuar, por shumë pak ka ndryshuar në lidhje me mënyrën se si "sistemi mashkull" dominon botën e biznesit. Gjinia është përcaktuesi më i fuqishëm se si një person e sheh botën dhe çdo gjë në të. Ky përcaktues është më i fuqishëm se raca, mosha, të ardhurat etj. Një gjë tjetër që ka ndryshuar këto tre dekadat e fundit, janë të gjitha faktet rreth roleve gjinore, fuqizimi i gruas, normat e diplomimit në kolegje, pjesëmarrjen në forcën e punës, shpenzimet e konsumatorëve, etj.

Pse duhet synuar tregu I grave?

Femrat përbejnë rreth 85% të gjithë blerjeve konsumatore duke filluar nga tregu I automobilave deri te kujdesi shëndetësor (She Economy). Gratë përbëjnë rreth 65% të konsumatorve për veshje, 52% të konsumatorve për blerjen e automjeteve të reja duke përfshirë këtu edhe 80% e ndikimit që ato kanë te të tjerët në këtë treg. Ato gjithashtu përbëjnë (Branding, Marketing ,Social) 45% të blerjeve të konsumit të produkteve elektronike, ato ndërmarrin rreth 80% të vendimeve rreth kujdesit shëndetësor për familjen, 70% të vendimeve të udhëtimit, 90% marrin pjesë në vendimet e investimeve, të sigurimit të daljes në pension.

Globalisht gratë kontrollojnë rreth 20 trilion \$ në shpenzime vjetore (Silverstein & Sayre, The Female Economy). Kjo shifer mund të shkojë në 28 trilion \$ në pesë vitet e ardhshme. Duke pasur parasysh këto shifra do të ishte qesharake injorimi apo nënvlerësimi i konsumatoreve femra.

Femrat po kontrollojnë ekonominë (Silverstein & Sayre, Women Wont More, 2008), në këto kohë ato kanë më shumë para në portofolet e tyre dhe shumicën e tyre ato i kanë fituar vet. Në tërësi, femrat që punojnë në tërë botën fitojnë rreth 12 trilion dollar nga pagat. Punonjëset femra në Amerikë fitojnë rreth 4.3 trilion dollar nga ky 12 trilionësh. Tre në dhjetë femra që punojnë (29%) fitojnë shumicën apo të gjithë të ardhurat në një familje dhe gjashtë nga dhjetë (62%) fitojnë rreth gjysmën e të ardhurave të familjes. Në ekonomitë e zhvilluara, 40% e femrave kontrollojnë 91 nga 100% shpenzimet shtëpiake. Femrat në Amerikë kanë ndikim më të madh në fitimin dhe konsumin e të ardhurave-më shumë se 72% e fitimit total të familjes janë të kontrolluara nga femra.

Të kuptosh arsyen se pse një grua blen është hapi I parë dhe më i rëndësishëm për të rritur biznesin tënd. Pothuajse në çdo shoqëri në botë gratë janë përgjegjëset kryesore për fëmijët, të moshuarit ndaj ato shpeshherë blejnë në emër të të tjerëve. Lista është e gjatë nëqoftëse në përfshijmë bashkëshortin, fëmijët, miqtë, të afermit, prindërit e moshuar. Nëse dikush ka nevojë për një dhuratë propabiliteti që një grua ta ndihmojë për ta zgjedhur atë është shumë i lartë.


Femrat duan shumë.

Ato duan barazi, pjesëmarrje (Silverstein & Sayre, Women Wont More, 2008), shanse dhe drejtësi në vend të punës dhe shoqëri. Ato duan ndjeshmëri, mirekuptim, lidhje, shëndet, dashuri, siguri dhe lumturi. Ato duan që ti dëgjosh nevojat që ajo ka. Ato duan që të kuptoni se si realisht i konsumojnë produktet apo shërbimet. Ato duan që ju të merrni parasysh pakënaqësitë e tyre. Ato duan një prodhim të ri që zhvillohet të orientohej drejt nevojave të tanishme dhe të dukshme. Ato duan që ju ta kuptoni që ato janë pjesë e një shoqërie punëtore të fuqishme dhe janë makina komunikuese shume te mira. Kjo do të thotë se ato tregojnë shumë për atributet e ndryshme të produkteve dhe shërbimeve, në mënyrë konstante dhe të përsëritshme.

Ato duan që ju të kuptoni se gratë kanë para për ti shpenzuar në mallra që ofrojnë vlera dhe kuptim si dhe kursejnë kohën por jo në produkte që janë stereotipe dhe që nuk kuptojnë nevojat e femrave. Ato duan që ju të dini që grate marrin shumë seriozisht çështjen e kohës dhe mungesës së saj. Ato duan që ju me anë të produkteve/shërbimeve që shisni të kujdeseni për jetën e përditshme, nevojat

dhe dëshirat, shpresat dhe ëndërrat e tyre . Ato duan të i pyesni, ashtu si ne se : ” Çfare duan femrat” ?

Nëse gratë ndalojnë së menduari në këtë mënyre, shumë industri do të rrezoheshin brenda natës kjo sepse gratë shërbejnë si një port për të gjithë të tjerët. Çdoherë që ju ofroni një shërbim cilësor te një grua ajo ka efekt shumëfishues ne biznesin tuaj pasi ajo grua përfaqson një gamë të gjerë të konsumatoreve të tjerë të mundshëm. Ajo ka shumë mundësi tu tregojë të tjerëve për shërbimin cilësor qe ajo ka marre nga ju.




Çfarë duhet të kenë parasysh marketierët kur I drejtohen grave?

Kompanitë të cilat i kuptojnë femrat nuk fokusohen më tek popullata si një e tërë, por tek segmente të vecanta dhe tek nevojat e këtyre segmenteve. Për t’i kuptuar vërtetë femrat dhe për të shfrytëzuar mundësinë e ekonomisë femërore kompanitë ndjekin të ashtuquajturat katër R (Silverstein & Sayre, What a Women Wont, 2008) njohja (recognize), kërkimi (research), reagueshmëria (respond) dhe përmirësimi (refine).

Më poshtë jepen përkufizimet dhe çfarë kuptohet me katër R:

Njohja (recognize) – Kompanitë e fokusuara tek femrat njohin/kuptojnë se femrat kërkojnë të mira dhe shërbime që kursejnë kohë, ofrojnë vlerë, ofrojnë rehati, janë të shëndetshme, dhe janë të

The ethics of social and educational research has been significantly complicated over the last several decades as a consequence of the "interpretive turn" and the ever-increasing use of qualitative research methods that have accompanied it. In this chapter, we identify what came before and after the interpretive turn with the traditional and contemporary approaches to research ethics, respectively. The distinction is a heuristic one.

We do not mean to suggest that the interpretive turn occurred at any precise point in time or that it has completely won out. In this vein, the traditional approach is no doubt still in currency. Embedded in the distinction between traditional and contemporary approaches is another between the protection of research participants ("research subjects" in the traditional vocabulary) and research misconduct. This, too, is a heuristic distinction, because it involves significant overlaps. In particular, research misconduct largely subsumes the protection of research participants. Nonetheless, it is a distinction that has the virtue of familiarity, since it parallels the way federal regulations and universities divide the issues in research ethics. *Source: University of Colorado at Boulder. Kenneth*

PERFUNDIMET: Globalizimi po ndryshon botën. Njerëzve dhe shoqërive u është dashur që të përshtaten në mënyre të shpejtë me realitetet e reja ekonomike, teknologjike, demografike, mjedisore dhe politike, dhe të përgatiten për të pranuar zhvillimet e mëtejshme. Këto ndryshime realitetesh kanë gjeneruar grupe të reja strukturash, aftësish dhe vlerash; pavarësisht se sistemi i arsimit shpeshherë mundohet së tepërmi për të ruajtur ritmin dhe për të përmbushur nevojat e një shoqërie në ndryshim në nivel botëror dhe lokal. (*Këshilli i Europës, 2014*).

Parlamenti Europian dhe Këshilli Europian kanë adresuar problematikat e sistemeve arsimore aktuale sidomos të atyre të Shteteve Anëtare, në disa dokumente të fundit; këto rekomandime duhet të ndiqen nga vendet anëtare dhe ato kandidate si Shqipëria. *Source: Përgatitur nga: Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)*

Ata duhet të rishqyrtojnë filozofinë e tyre të arsimit, duke theksuar nevojën për të pajisur të rinjtë me kompetencat e nevojshme për aktualitetin ekonomik dhe social (*Rekomandim i Parlamentit European dhe Këshillit European, 2006*), duke propozuar ndryshime në mjedisin e të mësuarit, pedagogjive të reja, qasjeve të reja ndër-kurrikulare, përfshirjes më të madhe të studentëve në hartimin e praktikave të tyre të mësuarit, dhe një trajnimi të plotë dhe tërësor të mësuesve (*Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin European, 2008*).

Kjo filozofi e rishikuar përafron mësimdhënien si një aktivitet moral, me shkollat që promovojnë integritetin dhe ofrimin e një shërbimi etik me mësuesit si agjent moral. Prandaj, trajnimi i mësuesve duhet të përfshijë zhvillimin moral dhe personal, njohuritë etike, dhe aftësitë reflektive (Campbell, 2003). Duhet të fokusohet në një përgjegjësi të përbashkët, atë të përdorimit të metodave aktive të të mësuarit, dhe të synojnë hapjen e dyerve të shkollave ndaj komunitetit (Gordon et al., 2008). Ato duhet të njohin dhe të adresojnë faktorët që rrisin pabarazinë dhe përjashtimin social dhe që rrjedhimisht rrezikojnë parimet themelore të shoqërive të qëndrueshme, të demokracisë dhe të drejtësisë sociale (*Këshilli i Europës, 2010*).

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Mësuesit janë shtylla themelore e procesit të ndërtimit të shoqërive të qëndrueshme demokratike dhe duhet të zhvillojnë kompetenca të tërthorta si: njohuritë e ndërlidhura, shkathtësitë dhe qëndrimet që u mundësojnë atyre për të modeluar proceset demokratike dhe pjesëmarrjen e bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, diversitetit dhe dinjitetit njerëzor (*Këshilli i Europës, 2010*)
Source: Përgatitur nga: Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)

Vetëm kohët e fundit etika është trajtuar si një çështje e rëndësishme në sistemin arsimor Shqiptar, në të shumtën e rasteve e adresuar në dokumenta të politikave dhe jo në praktikën e përditshme. Pas daljes nga regjimi komunist, gjatë të cilit institucionet e arsimit u përdorën si mjete politike të shpërndarjes dhe të kontrollit dhe në të cilin etika trajtohej nga këndvështrimi i “moralit socialist”, sistemi arsimor shqiptar ka kaluar në një proces reformash të njëpasnjëshme duke u përpjekur të rikrijojë veten e tij dhe të zhvillojë një identitet të ri.

Në këtë sfidë të madhe, vëmendje dhe rëndësi e lartë i është kushtuar rritjes së aksesit dhe të cilësisë së arsimimit, e cila trajtohet kryesisht në drejtim të arritjeve akademike. Prindërit kanë prirje të raportojnë sjelljet joetike në norma të ngjashme ose pak më të ulëta në krahasim me

mësuesit; megjithatë studentët në të gjitha rastet raportojnë frekuencë të lartë të sjelljeve joetike duke kulmuar me 83% prej tyre që raportojnë sjellje joetike në arsimin e lartë. Gjetjet sugjerojnë se diskursi për arsimin etik është i ri dhe në fillimet veta. Prindërit dhe mësuesit, në të gjitha nivelet e arsimit, raportojnë qëndrime pozitive ndaj praktikave etike të arsimit si të qënurit të rëndësishëm në cilësinë e arsimit dhe në mirëqënien e fëmijëve të tyre. *Source: Përgatitur nga: Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)*

Referencat: Campbell, E. (2003). The Ethical Teacher. Philadelphia: Open University Press.

Kohlberg, L. (1981). Essays on Moral Development: The Philosophy of Moral Development. New York: Harper Collins.

Gilligan, C. (1982). In A Different Voice. Cambridge, MA: Harvard University Press.

Goree, K., Pyle, M., Baker, E. & Hopkins, J.(eds) (2007). Education Ethics Applied. Boston: Pearson Education.

Pring, R. (2001). Education As A Moral Practice. Journal of Moral Education, 30(2): 101-112

Staratt, R. (2004). Ethical Leadership. San Francisco: Jossey-Bass.

Eleminimi i tatimeve të dyfishta në Kosovë

Msc. Arif Krasniqi¹

ABSTRAKT

Me globalizimin e ekonomisë dhe me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë, ekonomia botërore është kthyer në një treg të vetëm global, ku shtetet kushtëzohen të krijojnë kushtet e përshtatshme për të pasur qarkullim të lirë si të njerëzve ashtu edhe të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Tatimet në të gjitha format e shfaqjes së tyre kanë patur një rol kyç në zhvillimin e shtetit modern. Koha ka treguar që sistemet tatimore kanë qenë subjekt i ndryshimeve dhe përshtatjeve të vazhdueshme ndaj gjendjes së financave publike të vendit dhe ndryshimeve të aktivitetit ekonomik. Kësisoj, heqja e tatimit të dyfishtë mes shtetëve rajonale vlerësohet si fillimi i një marrëdhënie të re bashkëpunimi në mes të dy shteteve në nivel ekonomik. Si rrjedhojë këto marrëveshje bilaterale sjellin një mundësi më tepër për të shmangur evazionin fiskal i cili pengon zhvillimin e mirëfilltë të çdo shteti.

Komuniteti Ndërkombëtar përmes organizatave të ndryshme, ka parë të nevojshme hartimin e marrëveshjeve të tilla me anë të të cilave pengohet ikja nga tatimimi i dyfishtë apo evazionit fiskal. Edhe për shtetin e Kosovës, marrëveshje bilaterale për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimit të evazionit fiskal, kanë një rëndësi të veçantë për eliminimin e këtyre problemeve. Megjithatë, çdo marrëveshje kërkon t'i bëhet një interpretim adekuat, në mënyrë që të aplikohet në mënyrë të duhur për të luftuar dukurinë e cila është objekt i marrëveshjes dhe të mos krijohen paralelizma lidhur me të njëjtën çështje.

1. Përkufizimi i problemit

Në Kosovë çështja e tatimeve është kategori ligjore e paraparë me legjislacionin në fuqi. Me anë të tyre garantohet funksionaliteti i shtetit dhe ekonomisë të vendit. Megjithatë, lidhur me to dalin disa problematika apo pyetje duke filluar nga rregullimi ligjor, implementimi i tij në

Arif Krasniqi është asistent universiteti në lëmin e ekonomisë në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

jetën juridike dhe ekonomike dhe si rrjedhojë duke sjellur edhe mos-pajtuueshmëri me aktet ndërkombëtare lidhur me tatimet.

Me globalizimin e ekonomisë, dhe me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë, është bërë thuajse e pashmangshme mundësia që një person të krijojë të ardhura në një shtet dhe të mos ketë konflikt juridiksionesh me një shtet tjetër, i cili mund të paraqitet si shtet i rezidencës. Duke pasur parasysh që këto të ardhura sipas legjislacioneve vendore të dy shteteve mund të jenë të tatueshme, paraqitet problem i tatimit të dyfishtë, dhe shumë shpesh për t'i ikur tatimit të dyfishtë mund të paraqitet evazioni fiskal, i cili është i dëmshëm për zhvillimin e çdo shteti. Si zgjidhje për problemet e këtilla, komuniteti ndërkombëtar, përmes organizatave të ndryshme, ka parë nevojën e hartimit të marrëveshjeve me anë të të cilave bëhet eliminimi (shmangia) e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.

Rrjedhimisht, çdo marrëveshje kërkon t'i bëhet një interpretim adekuat, në mënyrë që të aplikohet në mënyrë të duhur për të luftuar dukurinë e cila është objekt i marrëveshjes dhe të mos krijohen paralelizma lidhur me të njëjtën çështje.

2. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë hartimit të punimit do të përdorim një mori metodash kërkimore dhe atë varësisht nga problemi, faza dhe të dhënat tjera të cilat do t'i paraqesim më poshtë:

1. Metoda e trajtimit teorik
2. Metoda e analizës.

3. Aspektet e përgjithshme teorike mbi Sistemin tatimor

Në kuadër të sistemit dhe politikës fiskale vend të konsiderueshëm luan sistemi dhe politika tatimore. Shikuar historikisht, paraqitja e tatimit dhe politikës tatimore është ngushtë e lidhur me paraqitjen dhe funksionet e shtetit. Duke pasur parasysh se gjatë historisë, roli dhe funksionet e shtetit janë zgjeruar, çka ka paraqitur nevojën edhe për mjete më të mëdha materiale, që në vete nënkupton edhe zgjerimin e llojeve të tatimeve. .

Shtrirja e funksioneve të shtetit në shumë veprimtari dhe zgjerimi i tyre ka kushtëzuar edhe paraqitjen e llojeve të ndryshme të tatimeve, të cilat së bashku përbëjnë sistemin tatimor. Megjithatë, “sistemi tatimor paraqet togun e të gjitha tatimeve të aplikuara në një vend të lidhur

në tërësinë konsistence, me të cilin mund të zbatohen (realizohen) qëllimet e politikës fiskale, përkatësisht realizimi i funksioneve publike të shtetit”².

Në teorinë profesionale ekonomike hasim në definime të ndryshme të tatimeve. Me këtë rast po i sjellim vetëm disa prej tyre³: Tatimi është ajo pjesë e pasurisë të cilën çdo qytetar ia jep shtetit. (Monotesquien); Tatimi është dhënie në para të cilat shteti i mbledh prej individëve në bazë të sovranitetit të vet, pa kundër shpërblim të drejtpërdrejtë, me qëllim të ngarkimit publik (Gaston Jeze)⁴; Tatimi është dhënie e detyrueshme pa të drejtë që të kërkojë kundër shpërblim (Funter Schmolder). Tatimi është çmimi, të cilin qytetari ia paguan shtetit për të kompensuar pjesën e vet të çmimit kushtues të shërbimeve publike, të cilat do t’i shpenzojë (De Viti de Marco);

Duke u mbështetur në atë që u tha më lart rreth tatimit, është vështirë që të jepet ndonjë përkufizim i prerë se çka paraqet tatimi. Por si do që të jetë, mund të thuhet se, tatimet janë instrument kryesor i të hyrave publike me të cilat shteti përcakton obligimin ndaj obliguesve tatimor me qëllim të financimit të sektorit publik, të shpenzimeve të përbashkëta, si dhe arritja e shumë qëllimeve në planin ekonomik e shoqëror.⁵

4. Karakteristikat e një sistemi tatimor modern

Një siste tatimor modern duhet të përmbushë disa kriteret. Ai duhet të jetë eficient që të sigurojë rritje ekonomike, shpërndarje të drejtë të të ardhurave dhe të shtojë fondet publike të nevojshme për sigurimin e të mirave publike, pa shtrembëruar vetë sistemin nëpërmjet efekteve negativ. Gjithashtu, një sistem tatimor modern duhet të jetë i drejtë, derisa ai ka për qëllim të orientojë ekonominë drejt shpërndarjes së dëshiruar të të ardhurave, pra të synojë barazi. Një sistem tatimor modern duhet të jetë i thjeshtë dhe transparent. Ai duhet të jetë dekurajues dhe të minimizojë nxitjet dhe mundësitë për shmangie tatimore, evazion fiskal dhe mashtrim. Gjithashtu ai duhet të ketë kosto të ulëta administrative.

Një sistem tatimor modern në mënyrë të përmbledhur mund të themi se mbështetet në këto karakteristika:⁶ *Efektiviteti ekonomik, transparenca, thjrshtësia administrative, fleksibiliteti, drejtesia*

Nsinojnë një sistem tatimor standard që me kalimin e kohës i është përshtatur gjendjes së vendit të tyre dhe zhvillimeve ekonomike dhe sociale.

² Limani, Musa (2003), “Makroekonomia aplikative”, Prishtinë, fq. 14.

³ Henderson, David (2007), “Klasikët e mendimit ekonomik, nga fillimet deri në ditët tona”, fq. 54.

⁴ Kadriu, Sabri, (2012), “Financat publike”, Prishtinë, fq. 81.

⁵ Kadriu, Sabri, (2012), “Financat publike”, Prishtinë, fq. 80.

⁶ Nane, Marsida, Shyti, Albana dhe Xhakaj, Gjenovefa (2013) “Ekonomi Tatimesh”, Tiranë, fq. 9

Tatimit është mbledhja e mjeteve financiare për shtetin dhe organet e tjera publike të cilat janë të nevojshme për financimin e funksioneve të tyre. Ky edhe është qëllimi fiskal i tatimit.⁷

Pra, detyra e tatimit nuk është ekskluzivisht realizimi i mjeteve financiare të shtetit, por tash me zgjerimin e numrit të obliguesve tatimor dhe me rritjen e numrit të llojeve të tatimit është bërë e mundur që tatimet të përdoren si instrument financiar shumë efikas për realizimin e qëllimeve të shumta ekonomike dhe sociale të shtetit.⁸

5. Tatimet dhe sistemi tatimor në Kosovë

Administrata Tatimore e Kosovës është autoriteti tatimor ekzekutiv përgjegjës për zbatimin e legjislacionit që ka të bëjë me tatimet.

Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përshtatshëm me atë të BE-së. Kjo vlen për tatimet dhe politikat doganore duke përfshirë tatimet direkte dhe indirekte (Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Dogana, Akciza, etj.).

Sistemi tatimor në Kosovë karakterizohet nga taksat me bazë të gjerë me norma të ulëta dhe pak përjashtime. Ekziston një boshllëk i konsiderueshëm tatimor në veçanti në mbledhjen e taksave mbi të ardhurat, gjë që reflekton madhësinë e ekonomisë joformale. Sfidat kryesore strukturore mbetet në reduktimin e varësisë nga tatimet dhe taksat e mbledhura në kufi dhe lëvizja drejt një strukture që do të jetë më shumë në linjë me zhvendosjen e ekonomisë drejt prodhimit më të fuqishëm vendas dhe të hyrave të mbledhura brenda vendit⁹.

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar drejt rregulloreve të thjeshta të cilat sigurojnë bazë të gjerë tatimore dhe parandalojnë evazionin tatimor. Tatimet dallojnë në bazë të formës së biznesit dhe qarkullimit vjetor. Administrata tatimore aplikon tri regjime të kryesore të tatimeve:

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh);
- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK);
- Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP).

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Tatimi kryesorë në Kosovë është Tatimi mbi vlerën e shtuar TVSH-ja e cila paguhet për mallra dhe shërbime. Norma e këtij tatimi është 8% për produktet e konsumit të gjërë dhe 18% për të gjitha mallrat tjera pa marrë parasysh origjinën e tyre dhe 0% për mallrat të cilat i dedikohen eksportit.

⁷ Komoni, Sabahudin, (2008), “Financat publike”, Prishtinë, fq. 47.

⁸ Po aty, fq. 48

⁹ Qeveria e Kosovës, (2015), “Programi kombëtar për reforma në Ekonomi”, Prishtinë, fq. 47.

Tatimi në të ardhurat e korporatave. Ky tatim paguhet çdo tre muaj varësisht nga qarkullimi vjetor. Norma e këtij tatimi me qarkullim vjetor mbi 50,000€ është 10%.

Tatimi mbi të ardhurat personale. Ky lloj tatimi aplikohet në të ardhura nga paga, biznesi, qiraja, interesi, pasuria e patundshme etj. Normat tatimore të tatimit në të ardhura personale nga paga janë normal progresive duke u bazuar në lartësinë e pagës së fituar dhe njëherit norma më të ulëta në regjion dhe në shtetet e BE-së.

Normat tatimore janë¹⁰:

- 0% deri në 960 euro/vit
- 4% mbi 960 dhe 3000 euro/vit
- 8% mes të 3001 dhe 5400 euro/vit
- 10% mbi 5400 euro/vit

Tatimi i paragjykuar. Ky lloj tatimi paguhet nga të gjitha bizneset individuale me qarkullim vjetor më pak se 100.000 euro.

5.Tatimi i Dyfishtë Ndërkombëtarë

Sistemi tatimor i një shteti përbëhet nga ligjet tatimore të tij, prandaj për të arritur deri te një sistem tatimor të drejtë, duhet të hartohen normat tatimore në atë mënyrë që ato të jenë të aplikueshme, dhe gjatë aplikimit të mos hasen në probleme të tjera, ose të paktën të evitohen këto probleme në shkallë sa më të madhe.

Gjatë hartimit të rregullave ndërkombëtare tatimore, një shtet duhet të synojë katër qëllimet e mëposhtme, disa prej të cilave mund të arrihen në mënyrë efikase edhe me veprim unilateral. Sidoqoftë për t'i arritur të katërtat, një shtet duhet të bashkëpunojë me partnerët e tij tregtarë më të mëdhenj.¹¹ Si çdo e drejtë tjetër, edhe e drejta tatimore ndërkombëtare ka burimet e veta, të cilat përfshijnë:¹²

Marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe. Konventa e Vjenës mbi të drejtën e traktateve, Traktati i Romës, procedurat e marrëveshjeve të reciprocitetit për zgjidhjen e kolizionit të juridiksioneve;

Marrëveshjet e plota për tatimet e dyfishta- traktatet dhe protokollet, shkëmbimi i letrave dhe notave, memorandumet mirëkuptimi, marrëveshjet administrative suplementare;

Marrëveshjet e kufizuara për tatimet e dyfishta- deklaratat reciproke, marrëveshjet specifike mbi lundrimin, tatimin e trashëgimisë dhe dhuratave;

¹⁰Salihu, Sami (2015) “Sistemi Tatimor në Kosovë”, Prishtinë, Nëntor, fq. 14.

¹¹ Brian J.Arnold & Michel J.McIntyre, International Tax Primer, v.c. fq. 4

¹²Genta Bungo, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, v.c., fq.190

E drejta ndërkombëtare zakonore dhe parimet e përgjithshme të së drejtës- parimet e së drejtës të njohura nga kombet e civilizuar në sistemet e tyre ligjore, e drejta statutoire, e drejta në përgjithësi dhe vendimet gjyqësore, si edhe praktikatat e organizatave ndërkombë. Tatimi i dyfishtë ndërkombëtar ndodh kur dy ose më shumë shtete taton në njëjtin tatimpagues për të njëtin subjekt tatimor. Tatimi i dyfishtë më së shpeshti paraqitet për shkak se shtetet nuk i taton vetëm asetet dhe transaksionet e brendshme, por edhe ato asete dhe transaksione në shtet tjerë të cilat përfitojnë nga tatimpaguesit rezidentë, duke çuar kështu në mbivendosje të kërkesave tatimore të shteteve. Traktatet bilaterale për tatimin e dyfishtë përcaktojnë dhe kufizojnë shtrirjen e tatimit të dyfishtë.

Tatimi i dyfishtë ndërkombëtar mund të paraqitet si tatim i dyfishtë juridik dhe tatim i dyfishtë ekonomik. Tatimet e dyfishta ekonomike i referohen tatimeve të dyfishta mbi të njëjtat të ardhura në duart e personave të ndryshëm (burrë e grua, partnerë të ndryshëm, kompani dhe filiale etj). I njëjti objekt është tatuar ligjërisht në mënyra të ndryshme, por ekonomikisht njëjloj.¹³

Ndërkaq, tatimet e dyfishta juridike kanë të bëjnë me të njëjtin objekt tatimor dhe të njëjtin subjekt tatimor, kur ata taton sipas dy ose me shumë juridiksioneve tatimore.¹⁴ Tatimi i dyfishtë juridik paraqitet atëherë kur në bazë të dispozitave të organeve tatimore të të njëjtë rang, për të njëjtën periudhë kohore ngarkohet me të njëjtin tatim ose me tatime të të njëjtë lloj, i njëjti subjekt tatimor ose objekt tatimor.¹⁵

Tatimet e dyfishta kanë këto karakteristika:

- Caktohen me ligj pagimi i tatimit nga ana e dy shteteve sovranë
- Obliguesi tatimor është i njëjtë
- Forma tatimore dhe objekti tatimor është i njëjtë
- Tatimimi bëhet në të njëjtën kohë¹⁶

Duke marrë për bazë faktin, se tatimi i dyfishtë ndërkombëtar, shfaqet në tatimin juridik, tatimi i dyfishtë ekonomik nuk do të jetë pjesë e shtjellimit të kësaj teme. Tatimi i dyfishtë juridik, siç e cekëm edhe më lart, paraqitet në rastet kur për të njëjtat të ardhura, kanë juridiksion tatimor dy apo më shumë shtete. Prandaj në këtë rast paraqitet ajo të cilën ne e quajmë “E Drejta Tatimore Ndërkombëtare”.

6. Konventat Model për lidhjen e marrveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë

¹³ Genta Bungo, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, Adel Print, Tiranë, (2009), fq. 193

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Prof.Dr.Sabri Kadriu, Financa Publike, Sabrico shpk, Prishtinë (2012), fq.143

Çështja e tatimit të dyfishtë, është çështje e cila preokupon të gjitha shtetet sovraane, pasi që ajo i jep të drejtën disa shteteve që të tatimojnë një tatimpagues duke u bazuar në parimin e rezidencës apo të burimit të të ardhurave, duke shpër kështu në mbivendosje të tatimit, e duke dëmtuar tatimpaguesin, pasi të ardhurat e tij zvogëlohen. Siç është shtjelluar edhe më lart, kjo pengon në qarkullimin e lirë të njerëzve, mallërave, shërbimeve dhe kapitalit.

Andaj, shtetet për t'i shmangur këto pengesa nëtatimin e të ardhurave dhe kapitalit, në mes vete lidhin traktate bilaterale për shmangjen e tatimit të dyfishtë.

Model konventat kryesore të cilat përdoren për lidhjen e traktateve bilaterale për eliminimin e tatimit të dyfishtë janë: Model Konventa e OECD-së (Organisation for Economic Co-operation and Developement), Model Konventa e UN (Kombeve të Bashkuara) dhe model konventa e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (US),.

7. Marrëveshjet për eliminimin e tatimeve të dyfishta

Marrëveshjet për eliminimin e tatimeve të dyfishta (METD) kanë një rol të rëndësishëm në faktorët që garantojnë, favorizojnë dhe stimulojnë marrëdhëniet ekonomiko-tregtare ndërkombëtare, si:

- Zhvillimi i bashkëpunimit për çështjetatimore;
- Mbrojtja e tatimpaguesit nga tatimimi idyfishtë;
- Parandalimi i evazionit tatimor;
- Eliminimi i diskriminimit;
- Ofrimi i asistencës administrative;
- Detyra të tjera të parapara me METD.¹⁷

Rëndësia e këtyre marrëveshjeve bëhet më e madhe në kushtet e rritjes së aktiviteteve të biznesit të shoqërive shumëkombëshe dhe të rritjes së vazhdueshme të lëvizjes së lirë ndërkombëtare të njerëzve, kapitaleve, mallrave e parave. Marrëveshja krijon një bazë të plotë ligjore për trajtimin tatimor të individëve apo personave juridikë të dy shteteve, të cilët kanë aktivitete biznesi apo të ardhura të tjera që bien nën juridiksionin e legjislacioneve tatimore të të dyja shteteve.

¹⁷Marr nga uebfaqja e ATK-së, http://ëëë.atk-ks.org/ëp-content/uploads/2015/10/Marrveshja-per-eliminimin-e-tatimit-te-dyfisht_Shqip.pdf, Maj, 2016




Figura 1 – Skema e METD sipas ATK-së

Tatimet e Dyfishta mund të bëhen pengesë për lëvizjen e individëve, shoqërive, kapitaleve dhe investimeve të ndërsjella nga një shtet tek tjetri. Janë pikërisht marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale për eliminimin e tatimit të dyfishtë, të cilat nëpërmjet dispozitave që krijojnë për palët nënshkruese, eliminojnë tatimin e dyfishtë duke përcaktuar se cili nga shtetet ka të drejtë të tatojë të ardhura të caktuara të një subjekti të caktuar, apo duke e ndarë këtë të drejtë mes të dy shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë.

8. Metodatat Për Eliminimin e Tatimit Të dyfishtë

Eliminimi i Tatimit të Dyfishtë bëhet përmes metodave të cilat i zbaton shteti rezident, si në rastet kur dispozitat e METD bien në kundërshtim me dispozitat e Legjislacionit vendor, dispozitat e METD kanë përparësi. Aplikimi i METD në rastet praktike do të bazohet në dispozitat konkrete në fuqi të çdo marrëveshjeje.¹⁸

- **Metoda e Lirimit**, e cila nënkupton lirimin nga tatimi për të ardhurat me burim nga jashtë.
- **Metoda e Kreditit**, e cila nënkupton lejimin e kreditimit tatimor për tatimin e paguar në të ardhurat me burim nga jashtë.
- **Metoda e Zbritjes**, e cila nënkupton zbritjen e tatimit të paguar për të ardhurat nga jashtë në formë të shpenzimit.

9. Marrëveshjet e Kosovës për Eliminimin e Tatimit të dyfishtë

Me qëllim të realizimit të Eliminimit të Tatimit të Dyfishtë, kriteret që merren për bazë, janë:¹⁹

- METD të jetë në fuqi dhe e zbatueshme;
- Personi duhet të jetë rezident në njërin apo dy shtetet kontraktuese;

¹⁸ Po aty, Maj, 2016

¹⁹ Marr nga uebfaqja e ATK-së, <http://ëëë.atk-ks.org/njoftim-per-tatimpagues-atk-publikon-fletepalosjen-marreveshja-per-eliminimin-e-tatimit-te-dyfishte/>, Maj, 2016

- Të ardhurat e tatuara të jenë të mbuluara nga METD.

ATK, garanton tatimpaguesit rezident dhe jo-rezident se të gjitha çështjet dhe informatat e tyre do të shqyrtohen në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, si dhe nën konfidencialitet të plotë, siç është paraparë në Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Traktatet që ka Kosova për eliminimin e tatimit të dyfishtë, e të cilat janë në fuqi, janë bërë pjesë e legjislacionit vendor, dhe janë të lidhura me këto shtete:²⁰

1. **Holanda-** traktat i lidhur me Jugosllavinë në vitin 1982, i cili aplikohet në mënyrë të njëanshme nga Kosova dhe nga Holanda (Holanda, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, me datë 22.09.2009, ka dorëzuar një shkresë përmes së cilës njeh vlefshmërinë e këtij traktati për të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë).
2. **Gjermania-** traktat i nënshkruar me Jugosllavinë, në vitin 1983, e përmes shkëmbimit të notave verbale për njohjen e vlefshmërisë së traktateve, është bërë ratifikimi në vitin 2010.
3. **Finlanda-** traktat i nënshkruar me Jugosllavinë në vitin 1987, pas shkëmbimit të notave verbale, është ratifikuar dhe është në fuqi në Kosovë nga 08.09.2011.
4. **Britania e Madhe-** traktat i nënshkruar me Jugosllavinë në vitin 1982, i ratifikuar së fundi me 09.07.2015 dhe e cila është e zbatueshme nga data 01.01.2016.
5. **Belgjika-** traktat i nënshkruar me Jugosllavinë në vitin 1980, vlefshmëria e të cilit njihet ende nga Belgjika. Ky traktat është amandamentuar dhe është në fuqi nga data 13.04.2012
6. **Shqipëria-** traktat i nënshkruar nga Kosova gjatë kohës së administrimit të UNMIK-ut, në fuqi që nga viti 2006. Traktati i ri pas shpalljes së Pavarësisë u arrit në vitin 2014 dhe ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2016
7. **Maqedonia-** traktat i nënshkruar nga Republika e Kosovës, në prill të vitit 2011, në fuqi që nga 01.01.2014
8. **Turqia-** traktat i nënshkruar në vitin 2012, dhe i cili ka hyrë në fuqi dhe zbatohet nga data 01.01.2016.
9. **Sllovenia** – Traktat i nënshkruar me datë 14.04.2014 dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015

²⁰По аты

10. Hungaria- traktat i nënshkruar së fundmi nga Republika e Kosovës dhe Hungarisë me datë 13.01.2014, ka hyrë në fuqi që nga data 01.01.2015²¹

Siç mund të shohim, shteti ynë qëndron ende varfër në rrjetin e tij të traktateve për

10. Ndikimi i eliminimit të tatimit të dyfishtë në investimet në Kosovë

Teoria e financave dhe investimeve jepin dëshmi të mjaftueshme të parakushteve kryesore për të investuar në Kosovë. Ekzistojnë dallime të vogla në perceptimin dhe rëndësinë që i është dhënë aspekteve të veçanta të mjedisit ndihmues për biznesin. Për investitorët aktualë, sundimi i ligjit, stabiliteti ekonomik dhe stabiliteti politik përbëjnë faktorët më të rëndësishëm gjatë përcaktimit të investimeve që i konsiderojnë këta faktorë si shumë të rëndësishëm për investime (4 në një shkallë prej 1-5).²² Marrëveshjet dypalëshe tregtare, traktatet e tatimit të dyfishtë dhe cilësia e infrastrukturës duket të jenë më të ulëta në listën e prioriteteve për investitorët aktualë, të ndjekur nga përvojat e investitorëve të tjerë të huaj dhe shërbimet përkrahëse të agjencive qeveritare e cila renditet më e ulëta.




Figura 2 – Rëndësia e faktorëve të lehtësimit të biznesit për investime (investitorët aktual)

Siç mund të shihet në figurën 2, pjesa më e madhe e investitorëve aktualë konsiderojnë sundimin e ligjit dhe rregulloret ekzistuese si një element të rëndësishëm në mjedisin e të bërit biznes, por edhe stabiliteti ekonomik dhe cilësia e infrastrukturës konsiderohen si dy aspekte shumë të rëndësishme të mjedisit të biznesit.

Nga ana tjetër, marrëveshjet dypalëshe tregtare, traktatet e tatimit të dyfishtë dhe përvojat ekzistuese të investitorëve të huaj duket se janë faktorë më pak të rëndësishëm, ndërsa

²¹Po aty, <http://ëëë.atk-ks.org/marreveshjet-tatimore-nderkombetare/altest/> Pril, 2016

²²MTI, “Perceptimet E Investitorëve Për Mjedisin E Biznesit Në Kosovë”, 2014, fq 15

Pak më shumë se 70% të investitorëve aktualë i konsiderojnë traktatet e tatimit të dyfishtë si faktor themelor për të vendosur mbi mjedisin e të bërit biznes.




Figura 3 – Rëndësia e faktorëve të lehtësimit të biznesit për investime (investitorët potencial) Gjithashtu shohim në figurën 3, se pjesa më e madhe e investitorëve potencial konsiderojnë njëjtë sundimin e ligjit dhe stabilitetin ekonomik si dy elemente të rëndësishme në mjedisin e të bërit biznes. Nga ana tjetër, marrëveshjet dypalëshe tregtare, traktatet e tatimit të dyfishtë dhe përvojat ekzistuese të investitorëve të huaj janë poashtu faktorë të rëndësishëm, për të vendosur mbi mjedisin e të bërit biznes.²³

Energjia, Infrastruktura, konsulenca, shërbimet financiare dhe sektori i prodhimit të mobileve i konsiderojnë traktatet e tatimit të dyfishtë si më të rëndësishme se bizneset në sektorët e tjerë. Marrëveshjet e tregtisë së lirë duket të jenë më të rëndësishme për bizneset në infrastrukturë, tregti, telekomunikacion, tekstile dhe mobile më shumë sesa në sektorë të tjerë.²⁴

Prandaj, marrëveshjet bilaterale kanë një rëndësi tejet të veçantë për sektorin e biznesit pasi që paraqet një standard të vetëm ligjor që mund të përdoret nga investuesit e të dyja vendeve.

²³MTI, “Perceptimet E Investitorëve Për Mjedisin E Biznesit Në Kosovë”, 2014, fq 16

²⁴Po aty, fq. 22

Përfundimet dhe rekomandimet

Rëndësia e eliminimit të tatimit të dyfishtë për të gjithë ata që zhvillojnë aktivitetin e biznesit në Kosovë rrit besimin dhe sigurinë për shmangien e tatimit në të dy vendet. Pra, kjo marrëveshje lejon tatim vetëm në njërin nga vendet për bizneset që zhvillojnë aktivitet në të dy vendet. Në këtë mënyrë bëhen hapa konkret lidhur me integrimin e ekonomisë dhe integrimin e biznesit të Kosovës.

Marrëveshjet ndërkombëtare mbi eliminimin e tatimit të dyfishtë dhe interpretimi i këtyre marrëveshjeve bëhet në të njejtën mënyrë si interpretimet e marrëveshjeve të tjera, pasi që rregullat bazë të cilat vlejné në këtë rast janë rregullat gjenerale të interpretimit të parapara me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve. Në shiqim të parë kjo mund të duket si gjë e thjeshtë, por siç është shqyrtuar gjatë punimit, interpretimi është një çështje delikate e që kërkon kujdes të shtuar në secilin hap të tij, pasi që një gabim i vogël mund të dërgoj në një përfundim krejtësisht tjetër nga ai për të cilin palët janë marrë vesh.

Interpretimi i këtyre marrëveshjeve është më i lehtë në rastet kur ato janë bazuar në model konveta (si ajo e OECD-së apo UN-it), pasi që këto organizata përgadisnin vazhdimisht komentare për secilin nen të modelit, e të cilët paraqesin rëndësi të madhe në rastin e interpretimit. Siç thuhet edhe në vet komentaret, interpretimi i neneve të konventës duhet bërë duke u bazuar në këta komentare, të cilët paraqesin burimin kryesor të interpretimit.

Gjithashtu vijmë në përfundim që për shkak të përdorimit më të madh të model konventës së OECD-së, edhe legjislacionet vendore kanë përfshirë të njejtat provizione të parapara në këtë model, duke lehtësuar kështu edhe arritjen e marrëveshjeve në mes të shteteve, si dhe duke mos dëmtuar tatimpaguesit. Të njejtën gjë e ka bërë edhe Republika e Kosovës, e cila përkundër faktit që është shtet në zhvillim ka inkorporuar në legjislacionin e vet vendor provizione kryesisht të bazuara në modelin e OECD-së, por në disa raste ka bërë kombinime me provizionet e modelit të UN-it.

Edhe pse si vend në zhvillim do të pritej nga shteti ynë të marrë parasysh modelin e UN-it në lidhjen e marrëveshjeve me shtetet tjera, por duke u bazuar edhe në pozitën gjeografike të Kosovës, e cila gjendet në Evropë, duke u bazuar në faktin që partnerë tregtie ka kryesisht shtetet të cilat janë anëtare të OECD-së dhe gjithashtu duke u bazuar në përqëndrimin e diasporës, e cila luan rol të rëndësishëm në të ardhurat e vendit, kryesisht në këto shtete, ky favorizim i modelit të OECD-së shihet si i arsyeshëm.

Prandaj, fare në fund mund të përfundojmë se sfidat kryesore të sistemit tatimor të Kosovës, respektivisht edhe ATK-së mbeten endefuqizimi dhe implementimi i mëtutjeshëm i arkave fiskale, funksionalizimi i deklarimit elektronik identifikimi i saktë i tatimpaguesve, inkuadrimi

i veriut të Kosovës, dhe nënshkrimi i mëtutjshëm i marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë, ndërmjet shteteve të cilat na kanë njohur deri më tani si shtet i pavarur.

Ndërsa sa i përket reformave, ky proces i integritit të Kosovës në BE, është një rrugë me shumë sfida ku një ndër to është edhe reforma tatimore pasi që ky integrim kushtëzohet vetëm në rastin kur sistemi tatimor i Kosovës, përafrohet me legjislacionin e BE-së më konkretisht me *acquis communautaire*. Megjithatë qëllimi i kërimit është edhe përcaktimi i një kornize ligjore të përshtatshme, e cila promovon efikasitetin dhe stabilitetin e sistemit financiar.

Andaj në fund rrjedhin edhe rekomandimet tona sa i përket temës në fjalë e të cilat janë:

1. *Harmonizimi i mëtutjshëm i legjislacionit vendor me legjislacionin tatimor të BE-së,*
2. *Zbatimi i marrëveshjes për eliminimin e tatimit të dyfishtë (METD), e cila ka për qëllim të përcaktoj shtetin i cili ka të drejtën e tatimit për të njëjtat të ardhura ose kapital, në rastet kur një person është i tatueshëm në të dy shtetet.*
3. *Shtetet anëtare të BE-së, duhet të përforcojnë format e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacioneve për sa i përket tatimit mbi të ardhurat personale, në luftën kundër evazionit tatimor dhe fshehjes së të ardhurave.*
4. *Shtetet anëtare të BE-së, duhet që të unifikojnë marrëveshjet për eliminimin e tatimit të dyfishtë. Marrëveshjet për eliminimin e tatimit të dyfishtë, shtetet anëtare i kanë huazuar nga modeli i Konvetës së OECD-së. Ndërkohë, nuk ka akoma një unifikim të modelit të marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë brenda shteteve anëtare.*
5. *Në kuadër të lidhjes së marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë, tatimi në burim duhet të marr përparësi në lidhje me tatimin mbi bazën e parimit të rezidencës në vendet anëtare të Bashkimit Europian. Aktualisht, shumica e marrëveshjeve tatimore që lidhen ndërmjet shteteve anëtare në Bashkimin Europian mbështeten mbi parimin e mbajtjes në burim të të ardhurave, por kjo nuk përjashton faktin që shtetet mund të zgjedhin edhe parimin e rezidencës për taksimin e të ardhurave të tyre, të fituara nga individë të caktuar, në shtete të ndryshme në Bashkimin Europian.*

Literatura

1. Arif Krasniqi është asistent universiteti në lëmin e ekonomksit në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
2. Limani, Musa (2003), “Makroekonomia aplikative”, Prishtinë, fq. 14.
3. Henderson, David (2007),” Klasikët e mendimit ekonomik, nga fillimet deri në ditët tona”, fq. 54.
4. Kadriu, Sabri, (2012), “Financat publike”, Prishtinë, fq. 81.
5. Kadriu, Sabri, (2012), “Financat publike”, Prishtinë, fq. 80.
6. Nane, Marsida, Shyti, Albana dhe Xhakaj, Gjenovefa (2013) “Ekonomi Tatimesh”, Tiranë, fq. 9
7. Komoni, Sabahudin, (2008), “Financat publike”, Prishtinë, fq. 47.
8. Po aty, fq. 48
9. Qeveria e Kosovës, (2015), “Programi kombëtar për reforma në Ekonomi”, Prishtinë, fq. 47.
10. Salihu, Sami (2015) “Sistemi Tatimor në Kosovë”, Prishtinë, Nëntor, fq. 14.
11. Brian J. Arnold & Michel J. McIntyre, International Tax Primer, v.c. fq. 4
12. Genta Bungo, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, v.c., fq. 190
13. Genta Bungo, Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, Adel Print, Tiranë, (2009), fq. 193
14. Po aty.
15. Po aty
16. Prof. Dr. Sabri Kadriu, Financa Publike, Sabrico shpk, Prishtine (2012), fq. 143

Burime nga Interneti

1. Marr nga uebfaqja e ATK-së, http://ëëë.atk-ks.org/ëp-/uploads/2015/10/Marrveshja-per-eliminimin-e-tatimit-te-dyfisht_Shqip.pdf, Maj, 2016
2. Po aty, Maj, 2016
3. Marr nga uebfaqja e ATK-së, <http://ëëë.atk-ks.org/njoftim-per-tatimpagues-atk-publikon-fletepalosjen-marreveshja-per-eliminimin-e-tatimit-te-dyfishte/>, Maj, 2016
4. Po aty
5. Po aty, <http://www.atk-ks.org/marreveshjet-tatimore-nderkombetare/altest/> Pril, 2016
- 5MTI, “Perceptimet E Investitorëve Për Mjedisin E Biznesit Në Kosovë”, 2014, fq 15
- 6 MTI, “Perceptimet E Investitorëve Për Mjedisin E Biznesit Në Kosovë”, 2014, fq 16
- Po aty, fq. 22

Ndikimi i kontabilitetit kreativ në raportimin financiar

Autori: Rustem Asllanaj¹

Abstrakti

Rritja e të ardhurave është komponent i rëndësishëm për suksesin e kompanisë. Duke u nisur nga kjo mund të themi që investitorët investojnë më shumë kapitalin e tyre kur firma ka më pak luhatje të fitimeve. Si rrjedhojë, menaxherët praktikojnë kontabilitetin kreativ apo aso politika të sheshimit të të ardhurave në mënyrë që të arrijnë objektivat e tyre. Edhe, Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit, GAAP, lejojnë një fare shkalle fleksibiliteti dhe interpretim të tyre.

Ky studim ka për qëllim të shqyrton kontabilitetin kreativ dhe ndikimin e tij në raportimin financiar modern. Një pyetje shumë e rëndësishme që kemi provuar të përgjigjemi në këtë studim është: se pse menaxherët përdorin kontabilitetin kreativ dhe si bëhen të suksesshëm në kryerjen e praktikës së tillë në prani të rregullave dhe procedurave të rrepta?.

Fjalet Kyçe: Kontabilitet kreativ; sheshim i të hyrave; raportim financiar; investime.

¹ Universiteti “Hasan Prishtina”. Fakulteti Ekonomik. Rustem.asllanaj@gmail.com

Hyrje

Sapo të dëgjohet fjala “Kontabilitet kreativ” në mendjen tonë portretizohet si një gjë negative, diqka e pandershme, manipulim, mashtrim. Kontabiliteti kreativ ka anet pozitive të saj. Madje, edhe vetë Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit, GAAP, lejojnë një fare shkalle fleksibiliteti dhe interpretim të kontabilitetit kreativ. Sipas shumë studiuesve (Ita Asuquo, 2011; Shah & Butt, 2011; Tassadaq & Malik, 2015) kontabiliteti kreativ karakterizohet si “armë”, që po u përdorë siç duhet, ajo mund të jetë me dobi të madhe për përdoruesit, por në qoftë se ajo është keqpërdorur ose shkon në duart e personit të gabuar, ajo mund të shkaktojë shumë dëme.

Kontabiliteti kreativ është “dredhi” e përdorur në raportim financiar për të moderuar raportet financiare të kompanisë për të inkurajuar investitorët të blejnë aksionet e kompanisë dhe për të rritur vlerën e tregut të firmës (Tassadaq & Malik, 2015).

Qelsi i popullaritetit në rritje të kontabilitetit kreativ është rritja e biznesit ndërkombëtar, duke e bërë konkurrencën midis firmave më të ashpër, prandaj, tundimi për ta që të bëjnë “rrugë përrreth rregullave” në kohën e caktuar dhe “pretekstin” në ndikimin e pasqyrave financiare bëhen më të dukshme (McCullagh, 2006 duke cit. Griffiths, L. 1987).

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të definojë kontabilitetin kreativ që përdoret në raportimin financiar dhe të paraqes perspektivën etike të kontabilitetit kreativ.

Qëllimi i këtij punimi nuk është vetëm të kuptohet rëndësia e etikës në raportimin financiar, por gjithashtu të theksohen ato faktorë që shkaktojnë praktika kreative jo-etike të kontabilitetit. Dhe po ashtu, të zhvillohet një model i propozuar i praktikave të kontabilitetit kreativ përmes rishikimit të literaturës.

Metodologjia e hulumtimit

- Metodologjia e përdorur për këtë punim ka kaluar nëpër këto faza:
- Se pari është identifikuar problemi kërkimorë lidhur me shqyrtimin e kontabilitetit kreativ;

- Së dyti është përpunuar plani orientues i punës kërkimore, pra është grumbulluar literatura edhe është përcaktuar bibliografia që do të përdoret.
- Së treti është përcaktuar struktura e punimit dhe pjesët përbërëse.
- Me pas është shtjelluar punimi sipas strukturës së përcaktuar bazuar në njohurit e fituara në bazuar në të dhënat cilësore të marra kryesisht nga libra, artikuj, studime, burime nga interneti.

Punimi është i organizuar si në vijim. Seksioni I hyrjen dhe metodologjinë. Seksioni II përfshinë rishikimin e literaturës dhe analizën e punimeve nga autorët e njohur të kësaj fushe. Seksioni III përfshin raportimin financiar dhe kontabilitetin kreativ, ndërsa Seksioni i fundit (IV) përfshinë përfundimin dhe disa rekomandime të derivuara nga ky hulumtim.

Rishikimi i literaturës

Bazuar në studimin e Tassadaq & Malik (2015) për heren e parë që është shkruar në literaturë, për kontabilitetin kreativ ka qenë periudha e viteve 1970-ta, dhe personi i parë që ka trajtuar konceptin “kontabilitet kreativ” konsiderohet Anglo-Saxon. Që nga viti 1970 e deri me sot, ende nuk ekziston ndonjë përkufizim i pranuar ndërkombëtarisht ose ligjor i **termi** “kontabilitet kreativ” (Bora & Saha, 2016; McCullagh, 2006; Tassadaq & Malik, 2015).

Studiues dhe organiza profesionale të kontabilitetit japin përkufizime të ndryshme mbi kontabilitetin kreativ:

Barnea, Ronen, & Sadan (1976):111, e përkufizojnë një formë të kontabilitetit kreativ siq është sheshimi i të ardhurave si: “zvogëlimi i qëllimshëm i luhatjeve rreth një niveli të fitimeve që konsiderohet të jetë normale për firmën”.

Ndërsa Schipper (1989) e përkufizon sheshimin (formë e kontabilitetit kreativ) si një ndërhyrje e qëllimshme në procesin e raportimit financiar të jashtëm, me qëllim të marrjes së disa përfitimeve personale.

Marin (2015) thekson në studimin e tij se kjo dukuri e quajtur kontabilitet kreativ u shfaq me qëllim të manipulimit të shifrave të kontabilitetit pa shkelur ligjin, duke e bërë atë një domosdoshmëri për të gjithë ekspertët në dhënjën e ideve, për të cilat nuk kanë gjetur ende zgjidhje kontabël.

Autoret Odia & Ogiedu (2013) e paraqesin kontabilitetin kreativ sipas dy këndvështrimeve: një pozitive dhe një negative. Nga këndvështrim pozitiv, mund të duket se kontabiliteti kreativ nënkupton shpikjen e parimeve dhe teknikave të kontabilitetit për t'u përshtatur me ndryshimet në mjediset ekonomike, sociale, politike dhe gjithashtu të biznesit. Nga këndvështrimi negativ, kontabiliteti kreativ nënkupton praktika të padëshirueshme që përvetsojnë elementë joetikë për tërheqjen e ofruesve të kapitalit duke paraqitur një gjendje mashtruese dhe pandershme të një pozite të fitimit të firmes.

Liberto (2019) e perkufizon kontabilitetin kreativ si “Kontabiliteti kreativ përbëhet nga praktikatat e kontabilitetit që ndjekin standardet, ligjet dhe rregulloret e kërkuara, por devijojnë nga ato në aspektin që ato standarde synojnë të arrijnë. Kontabiliteti kreativ kapitalizon mangësit në standardet e kontabilitetit për të portretizuar “në mënyrë kreative” një imazh më të mirë të kompanisë. Megjithatë praktikatat e kontabilitetit kreativ nga ky këndvështrim janë të ligjshme, zbrazëtirat që ata shfrytëzojnë shpesh qojnë në reformimin dhe refreskimin e standardeve të kontabilitetit për të parandaluar sjellje të tilla.

Pamvarsisht nga perkufizimet e shutma sa i perket kontabilitetit kreativ të gjitha e kanë një aspekt të përbashkët në të shpjeguarin e kontabilitetit kreativ: *si mjet i cili shërben për të normalizuar qëllimisht të ardhurat në mënyrë që menaxheret të arrijnë një trend të dëshiruar të fitimeve por edhe qëllimeve tjera të tyre.*

Metodat e Kontabiliteti Kreativ

Siq e kemi theksuar në Seksionin e dytë të këtij punimi mundësia për praktikimin e kontabilitetit kreativ lind për shkak të: fleksibilitetit të lejuar nga (GAAP) dhe SNK -të.

Kontabiliteti kreativ ekziston në shumë mënyra për shkak të vëllimit të vlerësimeve që kërkojnë gjykim dhe përvojë në hartimin e raporteve dhe pasqyrave financiare periodike. Më poshtë janë

disa shembuj të metodave të kontabilitetit kreativ (Amat & Gowthorpe, 2011; Biff Motley, 2002; Ita Asuquo, 2011; Largay, 2002; Odia & Ogiedu, 2013):

Metodat e kontabilitetit kreativ
Sheshimi i të ardhurave
Dritarja - Veshjet dhe rezervat sekrete
Financimi jashtë bilancor
Loja me numra
Dhe forma tjera

Burimi: Prezantim i autorit bazuar në (Amat & Gowthorpe, 2011; Biff Motley, 2002; Ita Asuquo, 2011; Largay, 2002; Odia & Ogiedu, 2013).

Ndikimi i kontabiliteti kreativ në Raportimin Financiar

Raportimi financiar është një proces që komunikon informacionin financiar të një biznesi afariste te përdoruesit e saj. Grupet e përdoruesve janë të shumët, dhe për këtë çështje, procesi i raportimit financiar të ndërmarrjeve shpesh është përballur me pengesën e kënaqjes së grupeve të ndryshme të përdoruesve me nevojat e tyre të larmishëm. Përmbushja e dëshirave të pronarëve të aksioneve në lidhje me fitimet e larta, dividendët mund të sjellin probleme të taksave të larta, kërkesës për paga më të larta dhe shpërblime etj. Nga ana tjetër, tendenca e ulët e fitimit mund të ketë një imazh negativ në mendjen e investitorëve lidhur me zgjedhjen e investimeve (Bora & Saha, 2016).

Nder format e kontabilitetit kreativ më të përdorura është sheshimi i të ardhurave: *Menaxhmenti i rrite fitimet kur mendon që objektivat e planifikuara nuk mund të arrihen dhe në rastin tjetër menaxhmenti i ulë fitimet kur realizon të ardhura me të larta se që i ka planifikuar për gjatë një vitit fiskal. Kjo sjellje e menaxhimit të kontabilitetit quhet zbutje e të ardhurave ose sjellje e zbutjes së të ardhurave*”(Barnea et al., 1976; Schipper, 1989).

Gjatë shfletimit të literaturës kemi hasur edhe në metodën e zbutjes artificiale të të ardhurave e cila u prezantua nga **Imhoff (1977)** dhe paraqitet përmes ekuacionit të mëposhtëm:

nëse: $I = S - CS_1 - C_2$	Të ardhurat në euro
dhe $C_2 > 0$	ku I = Të ardhurat në njësi monetare
dhe $C_{2,t+1} \geq C_{2,t}$	S = Të ardhurat nga shitjet në njësi monetare
dhe $0 < C_1 < 1$	C_2 = Kostot fikse në njësi monetare
dhe $C_{1,t+1} = C_{1,t} = C_1$	C_1 = Shkalla e kostove variabile në shitje të shprehur në njësi monetare
atëherë $CV_{\Delta S} \leq CV_{\Delta I}$	$CV_{\Delta S}$ = Koeficienti i variacionit për ndryshimin në shitje në njësi monetare
--	$CV_{\Delta I}$ = Koeficienti i variacionit për ndryshimin në të ardhurat në euro;

Qasja ndaj ndryshueshmërisë së të ardhurave e përcakton sheshimin e të ardhurave të kompanisë nëse:

$$\frac{CV_{\Delta I}}{CV_{\Delta S}} \leq 1$$

ku ΔI = Ndryshimi i të ardhurave për një periudhë

ΔS = Ndryshimi i shitjeve për një periudhë

CV = koficienti i ndryeshmërisë

$$= \frac{\sqrt{Variance}}{Expected Value}$$

Më poshtë e kemi paraqitur figurativisht vinë e hollë që e ndan kreativitetin me mashtrimin:




Figure 1. Vija e hollë midis kreativitetit dhe mashtirimit. Burrimi: (Diana & Mdlina, n.d.)

Ndërsa autorët **Charles W. Mulford dhe Eugene E. Comiskey** japin tre mënyra ku gjen përdorim kontabiliteti kreativ në pasqyrën e të ardhurave, e ato janë:

- Duke lëvizur zërat e pasqyrës së të ardhurave;
- Duke lëvizur shpenzimet nga kostot e shitjes në kategoritë e shpenzimeve të shitjeve, të përgjithshme apo administrative;
- Duke lëvizur operacionet jashtë klasifikimit të operacioneve jo të vazhdueshme.

Konkluzione dhe rekomandim

Për të përmbledhur diskutimin mbi praktikën e kontabilitetit kreativ, është një situatë që ne nuk mund të kufizojmë plotësisht ose ndalojmë shpërdorimin ose abuzimin e praktikave kreative të kontabilitetit andaj si përmbledhje i kemi paraqit Përparsit, të metat dhe pozicionin neutral lidhur me këtë fenomen të kreativitetit:

Përparsi: përdorimi i sheshimit të të ardhurave sinjalizon informimin privat të menaxhmentit për fitimet e vitit të ardhshëm të kompanisë.

Te meta: përdorimi sheshimit të të ardhurave fsheh informacion në lidhje me fitimet në vitin e tanishëm dhe vitin e ardhshëm të kompanisë.

Neutral: përdorimi i sheshimit të të ardhurave shfaq informacione për ecurinë e performancës ekonomike të vitit aktual që dihet në realitet nga menaxhmenti..

Literatura

Amat, O., & Gowthorpe, C. (2011). Creative Accounting: Nature, Incidence and Ethical Issues. *SSRN Electronic Journal*, 1–19. <https://doi.org/10.2139/ssrn.563364>

Barnea, A., Ronen, J., & Sadan, S. (1976). Classificatory Smoothing of Income with Extraordinary Items: Research Implications. *Accounting Review*, 51(1), 110–122. Retrieved from <http://links.jstor.org/sici?sici=00014826%28197704%2952%3A2%3C516%3ACSOIW%3E2.0.CO%3B2-F>

Biff Motley, L. (2002). Lessons from enron. *ABA Bank Marketing*. <https://doi.org/10.2308/acch.2002.16.2.153>

Bora, J., & Saha, A. (2016). Creative Accounting in Financial Reporting and its Ethical Perspective. *International Journal of Applied Research*, 2(3), 735–737.

Diana, B., & Mdlina, P. C. (n.d.). Is creative accounting a form of manipulation?

Ita Asuquo, A. (2011). The impact of creative accounting and earnings management on modern financial reporting.

Largay, J. A. (2002). Lessons from Enron. *Accounting Horizons*, 16(2), 153–156. <https://doi.org/10.2308/acch.2002.16.2.153>

Liberto, D. (2019). Creative Accounting Definition. Retrieved October 30, 2019, from <https://www.investopedia.com/terms/c/creative-accounting.asp>

Marin, A.-M. (2015). *The Professional Accountants Perception on Creative Accounting* (Vol. IV). Retrieved from www.scientificpapers.org

McCullagh, K. (2006). Creative accounting. *New Design*, (39), 16. https://doi.org/10.1057/9780230595019_6

Odia, J. O., & Ogiedu, K. O. (2013). Corporate governance, regulatory agency and creative accounting practices in Nigeria. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 4(3), 55–66. <https://doi.org/10.5901/mjss.2013.v4n3p55>

Schipper, K. (1989). Commentary on creative accounting. *Accounting Horizons*, 91–202.

Shah, A., & Butt, S. (2011). Creative Accounting : A Tool to Help Companies in a Crisis or a

Practice to Land Them into Crises. *International Conference on Business and Economics Research*, 16, 96–102.

Tassadaq, F., & Malik, Q. A. (2015). Creative Accounting & Financial Reporting: Model Development & Empirical Testing. *IJEFI*, 5(2), 544–551. Retrieved from <https://www.econjournals.com/index.php/ijefi/article/view/1047/pdf>

THE SEMIOTIC ANALYTICAL APPROACH OF INTERNATIONAL FAIRY TALES OF
SAINT “DONAT KURTI”

Lumturi Bardhi

Kurti's fairytales are an invention of our nation's psychology and without doubt we can say that these fairytales are the health that we inherited from the nation fairytales. Kurti's fairytales are considered as a form of narrative art. Atanzial model is an important component of the narrative structure in Kurti's fairytales. This model creates the way to pass the hero's obstacles from one circumstance in another through actions. These actions characterize the role of some characters. They are of the turned functions from potentially adapted characters to every form of narrator. The narrative function is found in every fairytale written by Kurti. A characteristic of these fairytales is the use of the third and first person. Collaborative movements, agreements, conflict, transformation, communication, atant-concrete object, izotopite, sema-topic, argument, the presence of mythologic element, the helper-the atanzial model/the helper (the river, the ash), the hero, the Antagonist, the Orderer, the text=with coolest network, affective experiences and irony are all included in these fairytales. The subject (The little and older brother) the atant object concrete (The two brothers, The bad guys) (abstract: the river that heals, the ash) Atant functions-the subject (The two brothers, The Author) the object taker-the reader/the destiny/the author and the destined-the reader. Kurti's fairytales are rich in figures and mythological structures. There are common characters in these fairytales that are: The mythological figures; the Clock, the House guardian, The most beautiful girl on earth, Saint Kolli, 7 Palms Beard and 3 Palms body, the devil and the dragons, As well as the king, the Little Brother and the animals. Besides mythological characters there are also mythological features that are an important component of the structure of these fairytales. Among the mythological features are: the hat, the knife, the bottle, the fig, the apple, the eallet etc. The compositional structure of the fairytales of Donat Kurt is the model or the way he lists topics, motives and episodes, the development of events from one voice at the beginning to the Climax and then to a happy ending. In Kurti's fairytales we have the entry formulas, the middle formulas and the concluding formulas. Just like the Proppolisting, the seven characters or the seven action scenes are also a characteristic in Kurt's fairytales. The action sphere of the hero, the action sphere of the Antagonist, the action sphere of the False Hero, the action sphere of the Leader, the action sphere of the Helper and the action sphere of the character being searched. In Kurti's fairytales, we notice that all tales have a description uniformity. They begin with a missing event, often caused by the destruction of the balanced beginning event. The obstacles of the main character bring the recomposition of the lost balance. The language used in these fairytales has its own characteristic form. There are used a lot of phraseological expressions, proverbs, blessings and curses. We can also find conjunctive form and subordinate constructions.

Keywords: mythological features, characteristics events.

NJË KËNDVËSHTIM ANALITIK- SEMIOTIK I “PËRRALLAVE KOMBËTARE” AT DONAT KURTI.
Lumturi Bardhi

Përrallat e Kurtit, fryt i psikologjisë së popullit dhe pa dyshim mund të themi se këto përralla, janë pasuria që na trashëgoi nga përrallat kombëtare. Përrallat e Kurtit konsiderohen si forme e artit narrativ. Model atanzial është një përbërës i rëndësishëm i strukturës narrative në përrallat e Kurtit. Ky model bën kalimin e pengesave të heroit nga një situatë në tjetrën nëpërmjet aksioneve. Këto aksione karakterizojnë rolet e disa personazheve. Ato zhvillohen dhe installohen si një model abstrakt të funksioneve të kthyer nga personazhet potencialisht të përshatshme në çdo formë të narrativit. Funksioni narrativ gjendet në çdo përrallë të Kurtit. Si veçori kemi përdorim e vetes së parë dhe të tretë. Tek këto përralla janë të pranishme, levizjet e ndërthurura, marrëveshja, konflikti, transformimi, komunikimi. objekti-atant-konkret, izotopite, sema-tema dhe argument, prania e elementit mitologjik, ndihmësit - Modeli atanzial / ndihmësi (lumi, hiri), heroi, Antagonisti, Urdhëruesi, dhuruesi, teksti = me rrjet kodesh, eksperiencë afektive, ironia. Subjekti (vella i madh e i vogël) objekti atant - konkret (dy vellezerit, keqberësit) / abstract: (lumi që sheron, hiri) Funksione atante - subjekti (dy vellezerit, autori) / objekti marrësi - lexuesi / destinuesi / autori. i destinuari / lexuesi. Përrallat e Kurtit janë të pasura me figura dhe mjete mitike. Personazhet e përbashkëta të këtyre përrallave janë: figurat mitologjike: Ora, Roja e Shpisë, E bukura e dheut, Shën Kolli, Shtat pllammjekerr e tri pllammshat, djallll kuçedra, dragoj. Personazhi i mbretit, Vëllai i vogël, Personazhet kafshë. Përveç figurave mitike edhe mjetet mitike janë përbërës të rëndësishëm të strukturës së këtyre përrallave. Ndër mjetet mitike më të përdorura janë: kapela, thika, shishja, fiku, molla, fyelli, luspa e peshkut, kuleta, penda e ndonjë shpendi etj. Struktura kompozicionale e përrallave të Donat Kurtit, është modeli, apo mënyra e renditjes së tematikës, motiveve e episodeve, shkallëzimit të ngjarjeve që ka një fillim që zë e zhvillohet vijimshëm për të arritur, në një pikë kulminante dhe më pas me një fund të lumtur. Në përrallat e Kurtit, kemi formulat hyrëse, të mesit dhe formulat përmbilëse. Ashtu siç i veçon Propp, shtatë personazhet, ose shtatë sfera aksioni (veprimi), karakteristikë është edhe për përrallat e Kurtit. Sfera e aksionit të heroit: Sfera e aksionit të Antagonistit, Sfera e aksionit të heroit Fals, apo antiheroit, Sfera e aksionit të Urdhëruesit, Sfera e aksionit të Dhuruesit, Sfera e aksionit të Ndihmesit, Sfera e aksionit të personazhit të kërkuar. Në përrallat e Kurtit, vërejmë se të gjitha kanë një lloj uniformiteti në rrefim. Ata nisin nga një situatë e munguar, shpesh e shkaktuar nga thyerja dhe prishja e situatës së ekuilibrit fillestar. Përmes peripecive të protagonistit sjellin rikompozimin e ekuilibrit të humbur. Gjuha që ai ka përdorur në këto përralla ka natyrën e saj karakteristike. Përdoren shumë frazeologjizma, fjalë të urta, proverb, urime, mallkime. Gjejmë në mënyrë të dendur të mënyrës lidhore, ndërtimet me nenrenditje.



Fjalë kyçe:Figurat mitologjike, mitike, ngjarje.

At Donat Kurti , lindi në Shkodër , më 3 shtator, 1903, në një familje intelektuale me tradita qytetare dhe atdhetare. Pasi mbaroj shkollën e mesme françeskane të Shkodrës, filloj noviciatin me 12 shtator të po këtij viti. Më 24, shtator, 1927 u shugurua meshtar. Vazhdoj studimet e larta në Romë , në universitetin “San Antonio”, ku u laurua në filozofi dhe teologji, ku ju dha tituli “ *Doktor i Shkencave* “ .

Po atë vit kthehet në qytetin e lindjes, caktohet edukator i kolegjit françeskan.Qëllimi kryesor ishte të ngjallte të kaluarën si histori dhe shprehje kulture. Kurti qe një studiues dhe gjurmues i thesarit popullor. Malësitë e Thethit , Currajt, Shalës, Shoshit, janë gurrat origjinale në të

cilat punoi ,përrallat, lojrat rapsoditë . Kallëzimet e Kurtit, janë origjinale, janë fryt i psikologjisë së shpirtit të popullit..Ai ka qënë një kallëzues besnik interpret i kallëzuesit të maleve.

Besnikëria e të të rrëfyerit është një element i folkloristit¹.

Në vitet 1942-1943, Kurti do të botojë në dy vëllime vepën e titulluar “ *Përralla Kombëtare* Vdiq me 10 nëntor 1983. Në një shtëpi të shkatërruar, në një provincë të Shkodrës, Zalli i Kirit. 10 vjet pas vdekjes merr medaljen “ *Pishtarë i Demokracisë*” dhe një vit më vonë merr titumin “ *Mësues i Popullit* “.

Përrallat shqiptare janë një thesar me vlerë të paçmuar, sepse na njohin me rrënjët tona të vërteta si një komb i veçantë që ka të kaluarën e vet të lashtë dhe individuale. Përralla është një nga zhanret më të rëndësishme dhe më komplekse të prozës gojore. Përralla ngjan me botën ku mrekullitë janë të natyrshme ndersa magjitë janë rregull. Përralla është fryt i imagjinatës prandaj dhe bota e saj është e pasur ku veprimet zhvillohen në botën tokësore, nëntokësore dhe atë qiellore. Kryerja e veprimeve dhe kalimi nga një botë në botën tjetër bëhet në mënyrë të natyrshme dhe pa asnjë vështirësi. Këto përralla mund të analizohen sipas strukturës së sistemit të 31 funksioneve të studiuesit të njohur, V.J.Propp. Këto funksione, nënkuptojnë veprimet e heroit të përrallës dhe të personazheve të tjera. Modeli atanzial, është një sistem i prezantimit ose i shfaqjes së foljes, që sistemon një lidhje zinxhir mes këtyre dy aspekteve: si urë lidhëse mes sintaksës së foljes dhe semiotikës së aksionit ose veprimit².

Përrallat e Kurtit, konsiderohen si formë e artit narrativ. Model atanzial bën kalimin e pengesave të heroit, nga një situatë në tjetrën , nëpërmjet aksioneve. Këto aksione karakterizojnë rolet e disa personazheve. Ata zhvillohen dhe instalohen si një model abstrakt të funksioneve të kthyer nga personazhet potencialisht të përshtatshme me çdo formë të narratorit. i quajmë funksione atante dhe i identifikojmë në tre çifte.

E rëndësishme në ndërtimin e këtij modeli, është gjendja që fiton rrëfimi i përrallës me anë të këtyre funksioneve, duke i indentifikuar në 3 çifte kryesore: Subjekti / Objekti ; Destinusi (Dërgusi)/ i Destinuari (Marrësi); Ndihmësi / Oponenti (kundërshtari), ka për qëllim të ndjekë një objekt të vlerës.

Subjekti dhe i adresuari (atant), nuk janë personazhe, por role narrative, që interpretohen nga i njëjti personazh. Funksioni narrativ, gjendet në çdo përrallë të Kurtit, modeli atanzial, është një përbërës i rëndësishëm në strukturën narrative në përrallat e Kurtit. Ky model, bën kalimin e pengesave të heroit dhe bën kalimin e situatave të heroit nga një situatë në tjetrën nëpërmjet aksioneve. Këto aksione karakterizojnë rolet e disa personazheve. Ato zhvillohen dhe bashkohen

¹ Jakova Fiorenca : “ Atë Donat Kurti OFM , Jeta dhe vepra “ , Shkodër , 2002, fq. 48.

² Ledri Kurti “ Dimensione dhe trajektore të mendimit semiotic “ , Shkodër, “ Camaj Pipa”, 2009; fq 43.

si modele më abstrakte të funksioneve të kthyer nga personazhet potencialisht të përshtatshme me çdo formë të narratorit.

Kemi një gërshetim të figurave mitike, mjeteve mitike dhe elementeve mitologjike.

Dukshëm në rrëfimet e tij mund të prezantohet figura e një Antisubjekti, që zhvillon një program narrative të njëjtë, por të kundërt respektivisht, me atë të subjektit për të ndjekur po atë objekt të vlerës.

Vlerësimi i objektit, vjen përmes ndërhyrjes së një figure të mëpasme atanziale që është ajo e destinantit që propozon motivimin e veprimit të subjektit.

I Destinuari, është figura atanziale, që lejon suksesin ose jo suksesin e aksionit të heroit – Subjekt. Në këtë mekanizëm abstract, përfshihen dy figura atanziale, ajo e **Ndihmësit**, që e mbështet **Subjektin** në arsyetimin e objektivit dhe figura e oponentit, që kërkon të pengojë aksionin e subjektit.

Modeli atanzia është i pranishëm në disa prej përrallave të Kurtit më konkretisht: **I Dekun në dasëm** (Bl1 fq 58), **E Drejta e Shtrembta**(Bl 2...), **Gërzhet**a (Bl2....), **Hyrija e Detit** (Bl2...), **Besa e Kunorës** (Bl1 fq 58)....

Në përrallën **E Dekun në Dasëm** jepet një periudhe kohe –Kur u nis në tjetrën jete ishte pranverë: kur u kthi ishte dimër i ftohtë dhe me akull .Kemi përdorimin e vetës së parë dhe të tretë.

Lëvizjet e kompleksura-dhënia e besës ndaj njëri tjetrit (dy shokët): martesë e njërit dhe ndekja e tjetrit: kujtimi i besës: vajtja tek varri: prania e mikut në dasëm: ikja në botën e përtejme: rikthimi në botën reale (mos njohja nga askush) etj.

Marrëveshja: midis dy shokëve (të cilët mos me ba dasëm dhe dek pa e thirr njanin-tjetrin)

Konflikti - midis gruas dhe burrit (burri thotë se ka kaluar një muaj gruaja thotë tre vjet)

Transformimi – kur hyjnë në botën e përtejme dhe del ne të sipërmen

Komunikimi – komunikon shoku me shokun (ngrihet nga varri)

Objekti atant – konkret (dasma, njerzit) – abstrakt (ngritja nga varri) etj

Izotopitë – hyrja në botën e përtejme dhe dalja në botën e sipërme

Semat – tema dhe argumentet – i dekun në dasëm/ të figurshmet – mbajtja e besës e qon të vdekurin nga varri. Kemi një tekst të hapur.

PO Ç'KANË TE PËRBASHKËTA PËRRALLAT E KËTYRE DY VELLIMEVE NË FUNKSIONET NARRATIVE TË TYRE?

Përrallat e Donat Kurtit, mund të analizohen sipas strukturës së sistemit të 31 funksioneve. Këto funksione nënkuptojnë veprimet e heroit të përrallës dhe të personazheve të tjera. Zakonisht rrëfimi në këto perralla është i përqendruar rreth personazhit kryesorë, aventurës së veprimeve dhe udhëtimeve, që ai ndërmerr për të arritur qëllimin e tij.Në shumë përralla mungojnë përshkrime mbi natyrën. Nuk është e thënë se secila përrallë t'i përmbajë 31 funksionet (sepse asnjë përrallë nuk i përmban të gjitha, por është e rëndësishme se funksionet më të rëndësishme i përmban pothuajse secila përrallë, ndërsa funksionet e tjera janë të kushtëzuara nga përmbajtja). Këto funksione janë: largimi; ndalesa; shkelja e ndalesës; interesimi; dhënia e informacionit; mashtrimi; pjesëmarrja; shkaktimi i dëmit; mungesa; ndërmjetësimi; kundërshtimi; shkuarja; takimi me dhuratë dhënësin; reagimi i heroit; fitimi i mjetit metik; bartja hapësore; ballafaqimi apo lufta me kundërshtarin;

Përrallat e blejve 1 dhe 2 të Kurtit janë te pasura me figura dhe mjete mitike. Vecori e tyre është se në to veprojnë një sërë qeniesh te mitologjisë universale dhe ato të mitologjisë sonë kombëtare . Ndër qëniet mitike shumë të funksionalizuara janë; Ora ;Roja e shtëpisë ; *E Bukura*

e DHeut ; Dragojtë ; Kucedra ; Hyritë ; Zanat; Shtat Pllamë mjekërr tri pllamë shtati ; Gjarpri ; Djalli; Divi; Shtriga ; Figurat njerëzore me veti mbinatyrore etj . Në përrallat e këtyre 2 vëllimeve , është shumë i pranishëm edhe figura biblike e shejtit Shënkolli. Shumë nga këto figura, jo vetëm që kanë rëndësi në ndërtimin artistik të përrallës, por ato hedhin dritë në mendësinë dhe mënyrën e jetesës sonë në periudha të ndryshme kohore.

Ngjarja e rrëfyer paraqitet tejte e largët, sa gati/gati e papërcaktueshme .. ajo bën një lidhje funksionale mes asaj që ka ndodhur diku dhe dikur me atë që duhet të zhvillohet në një prezent të kushtëzuar.

Qënieve të tilla në përrallat e Kurtit edhe pse të transformuara në figura artistike, ua atribuohen edhe aftesi me të cilat rregullohen dukuri dhe raporte në botën njerëzore. Këto figura në përrallë kanë fuqi mbi natyrore dhe hyjnore në të cilat i harmonizojnë raportet njerëzore me ato natyrore. Përveç qënieve mitike në përrallat e Kurtit veprojnë edhe një sërë mjetesht mitike me fuqi magjike, të cilat janë në funksion të ndihmësve që kryejnë detyrat e rënda apo i krijojnë pendesa kundërshtarit gjatë ikjes së heroit të përrallës sidomos gjatë ndjekjes nga kundërshtari.

Studiuesi i njohur *V.J.Propp* veçoritë e përrallës i kërkon në strukture në sintaksën e të cilës i përgjigjet uniteti i poetikës, i botës së ideve, i emocioneve të heroit dhe mjeteve gjuhësore. Ai e ka përpunuar modelin e përrallës, sipas fushëveprimit të personazheve

Ashtu siç i veçon Prop, shtatë personazhet ,ose shtatë sfera aksioni(veprimi), karakteristikë është edhe për përrallat e Kurtit. Për të vërtetuar sferat e aksionit , po marrim si shembull njërën prej përrallave të Donat Kurtit, përkatësisht përrallën “ **Gërzhetë**”.

- **Sfera e aksionit të heroit:** Protagonistit i historisë , është *Gërzhetë*.
- **Sfera e aksionit të antagonistit :** Kundërvënësi i heroit, janë katër vëllezërit, por më shumë vëllai i vogël, i cili donte t’a merrte për grua.
- **Sfera e aksionit të heroit fals, apo antiheroit:** Kush kërkon të shitet si hero ? Si hero don të shitet vëllai i vogël me veprimet e tia, duke kërkuar t’a bëjë për vete *Gërzhetën*.
- **Sfera e aksionit të Urdhëruesit:** Qe shtynë heroin, të niset për misionin e tij: Bukuria hyjnore e *Gërzhetës*, bën, që *vëllai i vogël*, të mos mendojë për asgjë tjetër, përveç asaj, duke e parë atë si gjënë më të vyer për të dhe për jetën e tij.
- **Sfera e aksionit të dhuruesit :** Kush jep një dhuratë magjike heroit? Është martesë imagjinare, që bën *Gërzhetë*, duke i dhuruar një djalë me bukuri hyjnore , burrit të saj.
- **Sfera e aksionit të ndihmësve.** Kush ndihmon heroin t’a çojë deri në fund misionit. *Gërzhetën* e ndihmon burri i saj (vëllai i vogël).
- **Sfera e aksionit të personazhit të kërkuar.** Personazhi i kërkuar është vetë *Gërzhetë*. Janë të gjithë elementet , të cilët e plotësojnë: nga petkat që ajo mbart, nga lumi ku ajo lahet, dhe gjoli i saj, janë elementet të cilat ajo nuk munt të jetojë pa to.
- Kemi marrëveshjen që bën vëllai i vogël me tre vëllezërit te tjerë, e cila është; *Vëllezërit , donin të martonin vëllain e vogël me Gërzhetën*. Ata i thanë, se duhet të vendosim tek *gjoli, një këmishë të bukur e me mënge të qepura, një pasqyrë, një krëhër, një sapun, e me hap 4 gropa e me u fshehtë të katërt ndër to*. Kur të vishet, ne do të dalim për me nxanë. Këto janë elemntë mitologjike, duke ja filluar që nga vetë *Gërzhetë, lumi, gjoli, pasqyra , sapuni* etj.
- Është i pranishëm,edhe funksioni mungesë tek kjo përrallë. Kjo tregohet tek elementi ; kalimi nga jeta ujore në atë tokësore. *Gërzhetë* në *gjol* jetonte si krijesë ujore, sirenë, ndërsa kur vinte në tokë jetonte si njeri i zakonshëm.
- **Objekti atant.** Zhvillimi i ngjarjeve, konkret/ apstrakt, janë personazhet, fuqia e tyre trupore, objekti në të cilat ato veprojnë.

– *Gërzhet* është *korbi* , është e barabartë me *nimfën*.

Formulat hyrëse, kanë rolin e sinjaleve të veçanta, që tregojnë se nga rrëfimi i zakonshëm kalohet në një rrëfim të organizuar artistik. Formulatat hyrëse në raste të tilla janë në rolin e kapërcyesve apo bartësve. Ato përmbajnë elemente të disa segmenteve , siç janë : koha, hapësira, personazhet. Përmes formulave hyrëse , sinjalizohet, edhe ndërtimi i strukturës tekstore , të përrallës. Kështu psh. tek përralla “ E bukura e dheut dhe shtriga “, kemi këtë situatë formulative initiale : Kishte pas kene një plak e një plakë, e i kishin pas tre djem . Secili djalë kishte një zant. Ma i madhi , ishte bulk e punonte tokën. I dyti ishte bari e shikojte gjanë , i treti ishte gjuetar. Një ditë prej ditë i thirri plaku të tre djemt,e u tha: Ju jeni rrit e ba burra, por amanet mbajeni ment ni fjalë që skeni me u pendue. Gjithsecili njeri e ka orën e vet e zoti ska lan ken pa te. Kur të jeni ngusht e ma ngusht, thirrni Orës , e Ora ka me u ndihmue. Pas situatës initiale formulative mund të supozojmë se funksioni i ardhshëm do të jetë mungesa, meqë vetë situata initiale kushtëzon funksionet qe do të pasojnë sipas një rënditje të caktuar. Funksioni *mungesa* është kushtëzuar nga porosia e babait që ua la tre djemve: “Kur të jenë ngusht e ma, thirrni Orës, e Ora ka me u ndihmue”.

Përveç formulave hyrëse në përrallë funksionon, sistemi i përsëritjeve, i formulave të mesit, formulave përfundimtare etj.

Formulat e mesit, janë përbërës të rëndësishmë të strukturës, narrative të përrallave të Donat Kurtit. Ato shqiptohen me rastin e kalimit të pengesave të heroit apo edhe për lidhjen e episodeve. Nëpërmjet tyre here-here behet edhe lidhja apo krijohet mundësia për kryerjen e detyrave të rënda etj. Formulatat e mesit janë në funksion dinamik, një funksion i tillë i tyre është i pranishëm në përrallën Hyjria e detit. Heroit të përrallës i ushtrohen kërkesa për kryerjen e detyrave që konsiderohen të pamundura. Kryerja e tyre realizohet me ndihmën e këshillëdhënësit(apo gruas së heroit të përrallës), dhe me veprimin e ndihmësve. Kërkesa e kryerjes së detyrave të rënda, është e tre hershme. Detyra e parë është “ *Me i gjet tre kutë cohe, qi të më dalin , me vesh ushtrinë e të teprojnë edhe njaq.....* ” Kërkesa e dytë është më e rëndë se e para, ndërsa e treta është edhe më e rëndë se sa dy të parat. ”.

Kjo strukturë formulative me simbolikë magjike përsëritet tri herë në këtë përrallë gjithnjë në funksion të kryerjes së detyrave të rënda për arritjen e qëllimit final të heroit të përrallës, kurorëzimin e jetës së lumtur.

Formulat përmbyllëse Në përrallat e D.Kurtit formulatat përmbyllëse janë segment i rëndësishëm i sistemit modelativ, sikurse formulatat hyrëse . Ato kanë funksion të bartësve apo kapërcyesve. Ato sinjalizojnë se nga rrëfimi i organizuar artistik kalohet në rrëfim të zakonshëm . Ato u nënshtrohen ligjshmërive të zhanrit dhe i takojnë tipit të klisheve të kanonizuara që rifunksionalizohen nga teksti në tekst dhe konsiderohen si sinjale të kodit të përrallës. Megjithatë formulatat përmbyllëse janë më të klishejuara se sa formulatat hyrëse për arsye se përrallat gjithmonë përfundojnë me fund të lumtur. Formulatat përmbyllëse janë të kushtëzuara edhe nga kronotopia e përrallës , nga misoni mitik nga natyra dhe karakteri fikcional.

Struktura kompozicionale e përrallave të Donat Kurtit, është modeli, apo mënyra e rënditjes së tematikës, motiveve e episodeve , shkallëzimit të ngjarjeve që ka një fillim zë e zhvillohet vijimshëm për të arritur, në një pikë kulminante dhe me pas me një fund të lumtur. Rënditja e veprimeve të personazheve, është kurdoherë në pajtim me paratekstin e përrallës me botën e saj, sa të rëndomtë e fantastike po aq e afërt dhe e përditshme.

Struktura kompozicionale e përrallë mitike zakonisht fillon me pakënaqësinë ndaj gjëndjes së personazhit ose me dëshirën e tij për të arritur një qëllim. Qëllimi lind vetvetiu, ose të cilin i kushtëzin situatë, dëshira për të udhëtuar, për të shkuar diku sa më larg. Kështu fillojnë shumica

e përrallave , apo kështu zë fill elementi i largimit të përsonezhit, që pastaj duke kaluar herë një pengesë e herë një tjetër , realizon qëllimin e shtruar që më parë.

Prej fillimit e deri në fund, struktura kompozicionale nëpërmjet përsonezhit kryesorë. gërshetohen motive episode, tablo të ndryshme në mënyrë vargu e kushtëzuese. Mjetet dhe elementet që përfshihen në pjesën kryesore, të strukturës kompozicionale të përrallës së Kurtit, janë të shumta dhe të ndryshme. Esencat e tyre largohen në formën e modelit që përrallën e cilëson dhe e dallon nga të gjitha krijimet në prozë qoftë nga ato gojore qoftë nga ato të shkruara. Përrallat e dy blejve , të Donat Kurtit, kanë një strukturë të qëndrueshme, kompozicionale. Në këto përralla, kemi akretipin shumëvetash. Elementi i përbashkët është numri dy, tre apo katër...Disa përralla e kanë të theksuar narracionin, disa të tjera gruhën në formën e dialogut. Psh. Përralla “ *Mai vogli vlla e send –e –gja*”. Kjo përrallë e ka më të theksuar narracionin .” *Ma i vogli , që ishte qelan, oshte djallë fort I kujtueshëm. Muer një ble e një pushkë e shkoi te molla. Cili një gropë deri në brez e u mshek mbrendë. Kush erdh si send –e- gja e u akp për molle, ky I ndjeti gati e e gjejeji bam! Edhe e palgosi*”.

Brenda përrallave të Kurtit , hasim edhe tekste te thurura poetike, në trajtë të poezisë mjaft të sukseshme. Kjo formë e rrefimit, përdoret nga narrator, për të shprehur botën emocionale të heroit, ku ai gjendet në situatë të vështira jetësore. Në shumë përralla, kemi një komunikim të koduar. Duke analizuar përrallat e Kurtit vërejmë se të gjitha kanë një lloj uniformiteti në rrëfim. Ata nisin nga një situatë e munguar, shpesh e shkaktuar nga thyerja dhe prishja e situatës së ekuilibrit fillestar. Përmes peripecive të protagonistit sjellin rikompozimin e ekuilibrit të humbur. Ato zhvillohen përmes lëvizjeve jo gjithmonë lineare, por shumë shpesh të ndërthurura ose të kompleksura. Kjo situatë e munguar, përbën një karakteristikë në përrallat e Kurtit dhe konkretisht:

- Tek përralla “*E Bukura e Dheut e Shtriga* “ **BL II fq 89**, funksioni mungese është kushtëzuar (shkaktuar) nga porositja e babait që ia la të tre djemve : *kur të jeni ngushtë e ma, thirrni Orës, e Ora ka me u ndimue*. Shkak I fillimit të veprimit pra I prishjes së harmonisë familjare në këtë përrallë është lindja e nevojës për kërkim-njohje, është I domosdoshëm për përrallën me që në të fillon thurja.
- Keto funksione i kemi te paraqitura edhe ne përrallat:
- *I dekun në dasëm , BL1, f.58,*
- *Besa e Kunorës, BL.2.fq.58.*
- *Gërzhet BL.2.fq.*
- *Kap e the, mat e pre, BL,2.fq.56etj*

Gjuha që ai ka përdorur në këto përralla ka natyrën e saj karakteristike. Përdoren shumë frazeologjizma , fjalë të urta, proverb, urime, mallkime. Gjejmë në mënyrë të dendur të mënyrës lidhore, ndërtimet me nënrenditje.

BIBLIOGRAFI

- Kurti Ledri. *Dimensionet dhe trajektoret tw mendimit semiotik*. CAMAJ-PIPA, Shkodër 2009.
- Kurti .Donat. At. Pwrrallat Kombwtare.(mbledhw prej gojws sw popullit), BL.1,2.At Gjergj Fishta -1942
- Jakova Fiorenca At Donat Kurti OFM Botime françeskane.Shkodër 2002

PASURITË MINERARE SI FAKTOR STRATEGJIK DHE PËRCAKTUES KRYESOR PËR PËRSPEKTIVEN E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Prof. Dr. Ass. Refik Kryeziu¹

Abstrakt

Në këtë punim, fokusi i trajtimit të temës është identifikimi i potencialeve minerare dhe orientimi i politikave investive, që mundësojnë në zhvillimin ekonomik, Trojet shqiptare posedojnë vendëburime të çmuara minerare si: ari, argjend, bakër, plumb, zink e tj, pastaj minerale jometalike, kaolinë, magnezitit, të energjisë, naftë, gazi, urani, lignite etj.

Në Shqipëri, ekzistojnë mase 50 minerale të çmuara, të llojeve e kategorive të ndryshme. Në Kosovë, ekzistojnë, mbi 22 minerale metalike, jometale e të energjisë. Sasi e konsiderueshme, e rezervave të mineraleve të çmuara gjenden edhe në trojet e tjera shqiptare, në Maqedoni, Çamëri, Kosoven lindore e në Malin e Zi.

Bazuar në përvojat e politikave zhvillimore të shtetesh të zhvilluara, konstatohet se pasuritë minerale, janë faktorë strategjik i zhvillimit ekonomik. Finalizimi ka përspektiven e vet zhvillimore, jep mundësi në zhvillimin e industrisë përpunuese. Pastaj, në punim do të konstatohet se përpunimi i këtyre pasurive, në fazat më të larta të prodhimit, është dimension i rëndësishëm në rritjen e ekonomisë dhe atribut i produktit shoqëror.

Fjalët kyçe: Resurset, mineraret, potencialet, finalizimi, zhvillimi ekonomik

1. HYRJE

Me trajtimin e këtij punimi, kemi realizuar një nga qëllimet kryesore, që ka të bëjë me kuptimin e premisë se pasuritë natyrore e minerale, kanë rolin dhe rëndësinë në zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi, e që për objektin kryesor i këtij punimi është se synimet të realizohen në shumë aspekte e në shumë drejtime.

Së pari: Është bërë identifikimi i rezervave e potencialeve të mineraleve në trojet shqiptare, ndërsa objektivat të realizohen duke hapur mundësi të zhvillimit ekonomik të kësaj hapsire.

Së dyti: Si rezultat i pasurive të mëdha, është një mundësi të investohet për revalorizimin e resurseve ekzistuese dhe hulumtimin e potencialeve të reja.

Së treti: Derisa, pasuritë minerale konsiderohet si faktor strategjik i zhvillimit ekonomik, hapen përspektiva të reja të investohet në këtë sektor të ekonomisë

Së katërti: Të gjenden forma për investime të përbahkëta, nga institucionet dhe afarist të ndryshëm, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve investuese dhe integruese në këto politika.

2. POTENCIALET E RESURSEVE MINERALE SI FAKTOR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

¹Profesor i rregullt, Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan. refik.kryeziu@uni-gjilan.com +38344230972, Republika e Kosovës.

Derisa resurset minerare janë faktor strategjik të zhvillimit ekonomik kjo premisë nuk e plotësohet tek ne. Në këtë kontekst shtrohet pyetja: Si është e mundur, që trojet shqiptare posedojnë pasuri të llojllojshme minerare, ndërsa kanë shkallë dhe nivel të ultë të zhvillimit ekonomik.

Trojet shqiptare kudo që shtrihen, kanë pasuri të mëdha natyrore, tokë të plleshme me bonitet të lartë, sasi të bollshme ujore, detet, liqenet, lumejtë, minerare të pasura të metaleve, të jometaleve e të energjisë.

Kështu që, si rezultat e posedimit të madh të llojeve e kategorive të ndryshme të cilësisë së lartë të pasurive minerare, ekzistojnë lloje të ndryshme e të shumta të lëndëve të para, të cilat mndësojnë në zhvillimin e tegut dhe të ekonomisë.

Lëndët minerale janë me prejardhje natyrore, si produkt i proceseve të komplikuar gjeologjike që paraqiten në koren e tokës, e të cilat eksploatohen dhe mund të përdoren ashtu siq gjenden në natyrë, ose përpunohen nëpërmjet të proceseve teknologjike, ndërsa nga ato përfitohen prodhime finale për përdorim të gjërë².

Në të gjitha vendet e botës, pasuritë minerare janë faktor strategjik të zhvillimit ekonomik. Shpenzuesit më të mëdhenj të resurseve natyrore janë vendet me ekonomi të zhvilluar, ndërsa shtrirja e tyre në botë është e pabarabartë mes vendeve të zhvilluara dhe atyre jomajfta të zhvilluara³.

Në Shqipëri, ekzistojnë minerare të shumta: rezerva të hekurit, niklit, bakrit, manganit, arit, argjendit, mandej qymyrit, naftës e gazit natyror.

Xehja e hekurit shtrihet në disa lokalitete, në rajonin e Pogradecit, të Librazhdit e Kukësit (Prenjas, Çërvënaka, Guri i Kuq etj). Kromi gjendet në Veri dhe në verilindje, në Rjonin e Martaneshit (Thekna, Guri i Thatë, Lugu i Thellë, Batra, Studenti) dhe me eksploatim dhe reserve zënë vend të rëndësishëm në Evropë dhe Botë. Po në këto rajone ekzistojnë reserve të bakrit, të arit e të argjendit (Kurbnesh, Gjegjan e Spaç.

Rezerva të naftës ka në Marinzë, Patozë e tjerë, të qymyrit në Alorupi, në Mëzezi e më gjërë. Miniera të njohura gjenden në Bulqizë, Rubik, Memaliaj, Mborje–Drenovë, Kurbnesh, Mëzez, Selenicë etj. Ekzistojnë rezerva të ndryshme të jometaleve si gëlqere, dolomitete e gipsit, lëndë e pare të qymentos, të qelqit, të tullave, silicate, magnezitet, argjilë e tj⁴.

Në Strategjinë e Zhvillimit të Industrisë Minerare, nga studimet gjeologjike të kërkim-zbulimit të kryera gjatë 50 viteve të fundit, janë konkretizuar vendburimet e rëndësishme të minerareve.

Në këtë strategji janë identifikuar burimet minerare, si rezervat gjeologjike dhe përbërja mineralogjike. Në tabelë janë pasqyruar mase 40 minerale metalike e jometalike: 1. Kromite, 2. Fe-Ni, Ni-silikat, 3. Bakeri, 4. Rerat bituminoze, 5. Bitume, 6. Pirobitume, 7. Titanomagnetite, 8. Boksidet, 9. Dolomitet, 10. Qymyrguri, 11. Torfat, 12. Tufe, 13. Bariti, 14. Gurë gëlqerorë, 15. Mergele, 16. Trepele, 17. Olivinite, 18. Gipse, 19. Rere kuarcore, 20. Bazaltet 1064(Te pakufizuara), 21 Kripë guri, 22 Gurë dekorativë, mermerë, 23. Argjila, 24. Kaolina, 25. Xham vullkanik, 26. Magnezite. 27. Feldshpate + albitofire, 28. Inerte lumore, 29. Fluoriti, 30. Squfuri, 31.

² Ramadani, I. (2013). Menaxhimi i resurseve natyrore, VATRA, Prishtinë, faqe 277.

³ Po aty, faqe 278.

⁴ Jakupi A. (1993). Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar, QIK, Prishtinë, faqe 44.

Shkriferimet, 32. Pirofilitet, 33. Talk + gure talku, 34. Shkumesi, 35. Fosforite, 36. Bojra Dheu, 37. Rere + çakell karbonatik, 38. Polimetalet 1.031 Cu 0.25-1.035, Zn 0.15-0.89%, Pb 0.15-0.29%, Au 0.39gr/t, Ag 6.5 gr/t, S 12%, 39. Platini 848 kg Pt 1-1.65gr/t, 40. Ari 13742.4 kg Au 1-4.4 gr/t⁵.

Kromi, bakri, qymyri, nafta e minerare të tjera vlerësohet se gjenden në sasi të mëdha, por përfitimet e vendit nga këto minerare janë të pakta. Vlerësohet se në nëntokën shqiptare ka naftë me vlerë të përgjithshme prej mbi 6 miliardë dollarësh, por pjesa dërrmuese e saj nuk është ende e mundur të nxirret nga nëntoka me teknologjinë aktuale të disponueshme, gjë që bën që vlera e përgjithshme e naftës të prodhuar të jetë rreth 300 milionë dollarë në vit⁶.

Në tokën e Kosovës gjenden lloje dhe kategori të ndryshme të pasurive minerare, të lëndëve të para, si:

a) Rezerva të energjetikës, b) Minerare të metaleve të çmuara dhe c) Xeherore të jometaleve me vlerë atrategjike:

a) Rezerva të energjetikës janë: lignitet, nafta e papërpunuar gaz e tjera,

b) Mineraret të metaleve të çmuara janë: ari, argjendi, pastaj metalet zingu, plumbi, piriti, mangani, kadmiumi, kallai, boksiti, bakri, nikli, antimoni etj,

c) Xeherore të jometaleve me vlerë atrategjike që janë një mundësi e zhvillimit të industrisë jometalike janë: magneziti, kaolini, kuarci, hallojziti, kuarci, azbesti, bentoniti, dektina rezistuese, tufi, argjila, mergelët për çimento, shkëmbinjtë e fortë silicate e karbonatikë, gurët dekorativë dhe dimensionalë e pasuri tjera.⁷

Mirë është e ditur se pushtuesi serb një kohë të gjatë, me egerësi prej okupatori pa mëshirë dhe pa ndërprerë shfrytëzoi sasi të madhe të pasuritve të ndryshme⁸.

Prandaj, nuk është e rastësishme që Serbia për shkak të pasurive të shumta minerare që posedon Kosova, gjithëmon ka pasur pretendime teritoriale, e së fundmi “beteja” politike e saj është të sillet rreth kompleksit minerar e teknologjik të “Trepçës.

Në anën tjetër, okupatori një kohë të gjatë shumë ka investuar për të bërë hulumtime të shumta rreth gjetjes së burimeve të minerareve në tokën e Kosovës.

Hulumtimet gjeologjike të papërfunduara kanë lënë ende të papërcaktuara rezervat e fosforiteve, kripës së gurit, baritit, gipseve. Kërkimet gjeologjike kanë sinjalizuar shenja inkurajuese për ekzistencën e naftës e gazit natyror, gjë që tregon se kjo trevë ka perspektivë të garantuar në sigurimin e lëndëve të para për zhvillimin e degëve të tjera të industrisë⁹.

⁵ Strategjia e Zhvillimit të Industrise Minerare Tiranë, Maj 2006. Burimi: http://www.sarmaproject.eu/%20uploads/media/MINERALS_STRATEGY-ALBANIA.pdf

⁶ <http://energija.al/2011/12/12/mineralet-e-shqiperise-miliardat-ne-thellesi-te-tokes-kompanite-kerkuese-dhe-spekulimet-ne-burse/>

⁷ Kryeziu, R. (2011) Ekonomia Kombëtare. - Përspektivat e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës, Univrsiteti AAB-RIINVEST, Prishtinë, faqe 185.

⁸ Prirodni bigatatsvo i njihove uticaj na razvoj strukturne promene u privredi Kosova. Botim i Institutit Ekonomik, Viti 1972. Prishtinë, faqe 187.

⁹ Daci, N. Berisha, S. Zajmi, A. Strategjia e zhvillimit ekonomik, faqe 135, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Oda Ekonomike e Kosovës, 2002, Prishtinë.

Hulumtimet gjeologjike të uranit janë realizuar gjatë viteve të 60-ta, kanë përfshirë pjesën lindore dhe verilindore të Kosovës. Punimet kërkimore me prospektim regional radiometrik si dhe me matje gjeofizike, i ka kryer kompania Geozavod, e cila edhe i posedon shënimet e plota për rezultatet e këtyre hulumtimeve. Sipas të dhënave të publikuara nga kompania kërkimore, është konstatuar një damar uranbartës në trahite, që është i pasuruar me uran dhe torium. Trashësia mesatare e damarit është rreth 1,4 metra, damari është konstatuar dhe është përcjellë në rënie dhe në shtrirje deri në 64 metra në thellësi dhe përmbajtja sillet nga 0,02 - 0,16%.

Në Kosovë ekzistojnë edhe shumë formacione gjeologjike që sot konsiderohen si potenciale (granitoidet, vullkanitet sidomos ato alkaline, sedimentet permo-triasike, basenet terigjene terciare etj.), në të cilat, do të duhej të orientohen hulumtimet e ardhshme.

Mirë është e ditur se pushtuesi serb një kohë të gjatë, me egerësi prej okupatori pa mëshirë dhe pa ndërprerë shfrytëzoi¹⁰ sasi të madhe të pasuritve të ndryshme¹¹.

Në Çamëri përveq minerale të shumta të metaleve e jometalebve me vleta të larta, ekzistojnë edhe rezerva e potenciale të mëdha të energjisë, të naftës dhe të gazit, që janë potencial i madh dhe perspektivë e zhvillimit ekonomik.

Edhe pse pjesa perëndimore e Maqedonisë e banuar me shqiptar, posedon sasi të madha të mineraleve, ndërsa në aspektin e zhvillimit ekonomik dallimet janë të theksuara, konsiderohen si teritore më të pazhvilluara në krahasim me pjesët e tjera.

Në zonën e Gucisë ekzistojnë dy miniera të arit dhe bakrit, njëra në malin Bor, tjetra në luginën e Ropojanës, në Vusanjë. Në komunat e Gucisë dhe Plavës janë zbuluar depozita të mëdha të bakrit me përmbajtje të lartë të metaleve në Bor, Kuk, Andrijevicë dhe në Konjusha.

Sipas disa burimeve, nga sateliti Amerikanët kanë zbuluar pasuri të madhe të varur në sulfur dhe mineraleve të tjera (argjendi bakri, plumbi)¹².

Në Malin e Zi, rajonet shqiptare në aspektin ekonomik janë më të pazhvilluara. Komuna e Ulqinit bie fjala me 17,5 km gjatësi të plazhes shumë cilësore me hapsirë të begatshme e me resurse tjera që rrall mund të gjenden në zonat bregdetare, rradhitet në fundin e listës sipas zhvillimit të qendrave të Malit të Zi, ndonëse natyra atyre nuk u ka falë kushteve aq të volitshme¹³.

Në Ulqinë ekzistojnë rezerva të mëdha të burimeve të kripës e që është produkt strategjik për jetën në përgjithësi. Plava, Gusia e pjesa tjetër e Malësisë, gati se ka mbetur sikur një shkretirë, pa njerëz, pa gjallëri ekonomike. Banorët që jetuan me shekuj në këto troje janë detyruar të shpërngulen, e të largohen në vende të ndryshme të botës.

¹⁰ Po aty, faqe 187.

¹¹ Shumë dyshohet se pushtuesi serb në vazhdimësi ka bërë hulumtime gjeologjike për të identifikuar rezervat e mineraleve në tërë teritorin e Kosovës, por se të dhënat nuk i ka publikuar për qëllime politike dhe strategjike.

¹² NEISKORIŠĆENO RUDNO BOGATSTVO GUSINJA <http://www.gusinje-info.com/neiskorisceno-rudno-bogatstvo-gusinja/>

¹³ Jakupi, A. (1993) Dy shtet shqiptare dhe bashkimi kombëtar, QIK, Prishtinë, faqe 168.

Në Kosovën Lindore gjenden rezerva të burimeve të mineraleve metalike si antimoni, kromi, bakri, prej jometaleve magneziti, kaolini, kuarci, feldshpati, mikat, bazalti, kasiteriti, sheliti, pastaj lëndë të para që shërbejnë për material ndërtimor si gëlqeroret e mermerizuar, rëra, zhavoret etj¹⁴.

Në Kosovën lindore, Banjën e Sijarinës e Bujanoc ekzistojnë vendburimet e ujërave termal e mineral të cilat janë të njohura jo vetëm në rrethinën e saj por edhe më gjërë. Kromi ndodhet në afërsi të fshatit Tërnavë, antimoni në Tërnoc te lokalitetet Potok, Prroi Kish, në mes të Breznicës dhe Tërnocit te Rruza e Gatë, Popçevë, Rid, Qifte, Potok, Vërshnik, Zabel etj. Edhe kaolini është i koncentruar në afërsi të fshatit Tërnoc. Minerali i hekurit shtrihet në hapsirën Çarrë-Sedllar, ndodhen rreth 1.800.000 tonelata xehe, si dhe hematitet.

Në teritorinë e Medvegjës, në vendburimet e Leces, në Tullarë dhe Banjën e Sijarinës gjenden xehe të plumbit, zinkut e bakrit. Në veri të fshatit Gazdare hasen paraqitjet e opalit, kalcedonit, ametisitit dhe e ahatit. Prej mineraleve jometalike afër fshatit Somalicë dhe Levosovë, eksploatohen kuarci, feldshpati dhe muskoviti¹⁵.

Shqiptarët e Kosovës Lindore, Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës përkundër që posedojnë minerale të llojeve të ndryshme, me cilësi të lartë për mundësinë e zhvillimit të industrisë janë në pozitë të rëndë ekonomike e sociale, pa të drejtat më elementare, të mos flasim për zhvillimin ekonomik, pra, konsiderohen si komunat më të pazhvilluara në Serbi.

3. PASURITË MINERALE ZHVILLOJNË EKONOMINË DHE NDRYSHOJNË STRUKTURËN E SAJ

Historikisht, okupator të ndryshëm, pretenduan tokat shqiptare, si rezultat i këtyre argumenteve se trojet shqiptare janë shumë të pasura me resurse natyrore, pra janë të pasura me shumë minerale të çmuara dhe se kanë pozitë shumë të volitshme gjeostrategjike.

Faktori ndërkombëtar ¹⁶ me vendimet e njëanëshme e padrejtësive që u bënë shqiptarëve la pasoja të mëdha në shumë aspekte, në aspektin politik, ekonomik dhe social, që edhe tani këto pasoja të mëdha po ndihen edhe sot e kësaj dite.

Kështu që, edhe pse trojet shqiptare janë të pasura me resurse të çmuara natyrore, në aspekti të zhvillimit ekonomik ka ngecje të theksuara, në krahasim me shumë vende në përmasa ndërkombëtare, të cilave këto lloje e sasi në përgjithësi nuk i kanë.

Bazuar nga të dhënat konstatohet se trojet shqiptare janë të pasura me minerale të llojllojshme të kategorive të ndryshme, ndërsa premiset tregojnë se janë faktor strategjik në zhvillimin e industrisë e të ekonomisë, dhe se që ky faktor strategjik i zhvillimit ekonomik vërtetohet edhe me argumente shkencore.

¹⁴ Ejupi, A. (2016). Natyra e Luginës së Preshevës, Struktura, determinantat dhe resurset natyrore, Prishtinë, faqe 100.

¹⁵ Po aty, faqe 121 - 127.

¹⁶ Konferenca e Londrës e vitit 1912-1913 ishte një samit ndërkombëtar i gjashtë Fuqive të Mëdha të asaj kohe (Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia dhe Italia).

Sublimimi duhet të sigurojë argumentin e këtyre premisave¹⁷:

- Se pasuritë natyrore kanë qen faktor i rëndësishëm i zhvillimit
- Se pasuritë natyrore kanë mundur të jenë faktor më i rëndësishëm dhe
- Se pasuritë natyrore jenë faktor më i rëndësishëm sesa në periudhën e kaluar

Nga këto kuptojmë për rëndësinë e minerare në zhvillimin ekonomik. Mirëpo rrethanat politike dhe ekonomike që dominonin për një kohë të gjatë dhe rrethanat që kanë ndikuar, kanë kufizuar mundësitë për të e zhvilluar ekonominë¹⁸.

Prandaj, është rast tipik për të potencuar slloganin se trojet shqiptare janë në pozitë të pavoritshme ekonomike, vend i pasur në një vend të varfër. Kështu që edhe pse posedojnë pasuri të pakufizuara natyrore e minerare ekonomia e tyre është e pazhvilluar, krahasuar me vendet e thërra që shumë nga llojet e mineraleve të çmuara nuk I posedojnë fare.

Politika e shfrytëzimit të pa kontrolluar kanë lënë pasojë të mëdha në strukturën e ekonomisë në përgjithësi¹⁹.

Struktura ekonomike e trevave shqiptare përbëhet nga tre sektor kryesorë:

1. Sektori i parë i ekonomisë i cili ka për bazë ekonominë bujqësore,
2. Sektori i dytë i ekonomisë, me të cilën nënkuptohet para se industria,
3. Sektori i tretë i ekonomisë i cili përfshin alltëvitetet e shërbimeve, tregëtinë, transportin, turizmin etj²⁰.

Si rezultat i potencialeve të resurseve minerare, ekzistojnë mundësi dhe pëspektiva, që ekonomia të zhvillohet e orientohet përmes finalizimit të lëndëve të para.

Finalizimi është një dimension që ka implikim të veçantë në industrinë dhe në degët përpunuese, që krijohet mundësia për një zhvillim më të hovshëm të ekonomisë dhe të punësimit më të lartë.

Finalizimi, është faza më e lartë e përpunimit dhe është atribut i produktit shoqëror²¹. Kështu që, finalizimi I pasurive minerale do të mundësonte zhvillimin e industrisë përpunuese, do të prodhohen produkte strategjike për ekonominë, mundësohet rritja ekonomike, shtimi më hovshëm i të ardhurave kombëtare, shtimi i punësimit, do të ndryshohet struktura e ekonomisë, zhvillohet tregu, sidomos për eksport e shumë të arritura tjera në përgjithësi.

PËRFUNDIMI

¹⁷ Gusia, I. (1982). Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik, Prishtinë. Faqe 43.

¹⁸ Kryeziu, R. (2011).Ekonomia Kombëtare-Përspektivat e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës, Universiteti AAB-RIINVEST, Prishtinë, faqe 129.

¹⁹ Kjo argumentohet me faktin se në Kosovë dhe trojet tjera shqiptare, mineraret janë eksploatuar dhe menaxhuar nga pushtuesit e ndryshëm.

²⁰ Cërabregu, M. Sadiku M.(2016). Gjeoeconomia - implikimet zhvillimore, Shtëpia botuese Dukagjini, Pejë, faqe 93.

²¹ Jakupi, A. (1985). Finalizimi dimension i strategjisë së zhvillimit të Ekonomisë së Kosovës, Rilindja, Prishtinë, faqe 147.

Bazuar në trajtimin e temës dhe të arriturat që dolën nga punimi japim këtë përfundim: Që në nivelet akademike, institucionet universitare e shkencore të hartojnë programe dhe strategjinë e zhvillimit ekonomik, duke u mbështetur në potencialet minerare, të eksplorimit, revalorizimit shfrytëzimit të tyre me qëllim të jenë në funksion të rritjes së ekonomisë e të mirëqenjes së popullatës. Të hartohen projekte zhvillimore për mundësinë e finalizimit të resurseve minerale duke arsyetuar premisat se pasuritë natyrore janë faktor strategjik i zhvillimit ekonomik.

LITERATURA:

1. Cërabregu, M. Sadiku M. (2016) Gjeoeconomia-implikimet zhvillimore, Shtëpia botuese Dukagjini, Pejë, faqe 93.
2. Daci, N. Berisha, S. Zajmi, A. Strategjia e zhvillimit ekonomik, faqe 135, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Oda Ekonomike e Kosovës, 2002, Prishtinë.
3. Ejupi, A. (2016). Natyra e Luginës së Preshevës, Struktura, determinantat dhe resurset natyrore, Prishtinë, faqe 100.
4. Gusia, I. (1982). Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik, Prishtinë. Faqe 43.
5. Jakupi, A. (1985). Finalizimi dimension i strategjisë së zhvillimit të Ekonomisë së Kosovës, Rilindja, Prishtinë, faqe 147.
6. Jakupi A. (1993). Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar, QIK, Prishtinë, faqe 44.
7. Kryeziu, R. (2011) Ekonomia Kombëtare-Përspektivat e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës, Universiteti AAB-RIINVEST, Prishtinë. Faqe 185.
8. Ramadani, I. (2013). Menaxhimi i resurseve natyrore, VATRA, Prishtinë, faqe 277.
9. Strategjia e Zhvillimit të Industrisë Minerare Tiranë, Maj 2006. Burimi: http://www.sarmaproject.eu/%20uploads/media/MINERALS_STRATEGY-ALBANIA.pdf ¹
10. <http://energija.al/2011/12/12/mineralet-e-shqiperise-miliardat-ne-thellesi-te-tokes-kompanite-kerkuese-dhe-spekulimet-ne-burse/>
11. Prirodni bigatatsvo i njihove uticaj na razvoj strukturne promene u privredi Kosova. Botim i Institutit Ekonomik, Viti 1972. Prishtinë, faqe 187.
12. NEISKORIŠĆENO RUDNO BOGATSTVO GUSINJA <http://www.gusinje-info.com/neiskorisceno-rudno-bogatstvo-gusinja/>